LIGJ
Nr. 29/2023

PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT[1]

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi i ligjit

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave në lidhje me:
a) tatimin mbi të ardhurat e personave fizikë dhe entiteteve;
b) tatimin mbi të ardhurat nga trashëgimitë, dhurimet dhe fitimet nga lojërat e fatit.
2. Qëllimi i këtij ligj është hartimi i një kuadri ligjor mbi përcaktimin e rregullave për vendosjen, deklarimin dhe mbledhjen e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi të ardhurat e korporatave, si dhe të tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale dhe tatimit mbi të ardhurat e korporatës për të ardhurat e tatueshme nga të gjitha burimet, të realizuara brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në një vit tatimor të caktuar.
2. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj, personat jorezidentë janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat në këto raste:
a) për totalin e të ardhurave të tyre të tatueshme në mbarë botën, që i atribuohen një selie të përhershme në Republikën e Shqipërisë; dhe
b) në masën që nuk përfshihen në shkronjën "a", të ardhurat e tyre të tatueshme nga të gjitha burimet, që kanë një burim në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 4 të këtij ligji, në një vit të caktuar tatimor.

Neni 3
Përkufizime

---

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me:*
- Direktivën e Këshillit (BE) 2016/1164, datë 12 korrik 2016 "Mbi përcaktimin e rregullave kundër praktikave të shmangies së tatimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e tregut të brendshëm", e ndryshuar. Numri CELEX 32016L1164, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 193, datë 19.7.2016, f. 1–14.
- Direktivën e Këshillit 2009/133/KE, datë 19 tetor 2009 "Mbi sistemin e përbashkët tatimor të zbatueshëm për bashkimet, ndarjet, ndarjet e pjesshme, transferimet e aktiveve dhe shkëmbimet e aksioneve në lidhje me shoqëritë e shteteve të ndryshme anëtare dhe për transferimin e selisë së regjistruar të një SE ose SCE midis shteteve anëtare", e ndryshuar. Numri CELEX 32009L0133, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 310, datë 25.11.2009, f. 34–46

Për qëllime të këtij ligji, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

1. “Person” është çdo person fizik dhe entitet.

2. “Person fizik” është çdo:

a) individ i vetëpunësuar;

b) individ tregtar;

c) individ sipas kuptimit të Kodit Civil, përfshirë të punësuarit, si dhe çdo individ tjetër person fizik që realizon të ardhura nga çdo burim, përfshirë dhurimin, trashëgiminë apo fitimet nga lojërat e fatit.

3. “Entitet” nënkupton çdo shoqëri apo çdo strukturë të organizimeve të korporuara apo të jokorporuara, pavarësisht formës, të natyrës fitimprurëse ose jofitimprurëse, ku përfshihen, por pa u kufizuar, si më poshtë:

a) çdo formë e shoqërive sipas Kodit Civil ose legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare;

b) organizatat fitimprurëse dhe jofitimprurëse;

c) ndonjë formë “trusti” i huaj apo strukturë të ngjashme;

ç) ndonjë formë bashkëpunimi/partneriteti, që ka një formë juridike dhe mund të trajtohet si një tatimpagues i vetëm;

d) çdo formë bashkimi ndërmarrjesh (shoqëri e përbashkët);

dh) çdo formë shoqërie menaxhimi kapitalesh apo asetesh;

e) çdo formë bashkëpunimi/partneritetet pasiv;

ë) çdo shoqëri tjetër e krijuar me ligj të veçantë.

4. “Shoqëri” nënkupton çdo shoqëri tregtare të themeluar, të organizuar dhe të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe për Qendrën Kombëtare të Biznesit.

5. “Individ i vetëpunësuar” është çdo person fizik i angazhuar në furnizimin e çdo lloj shërbimi apo i angazhuar në veprimtari të tjera profesionale, të ndryshme nga veprimtaria tregtare.

6. “Individ tregtar” është çdo person fizik i angazhuar në veprimtari tregtare.

7. “Tatimpagues” është çdo person, i cili është subjekt i tatimit sipas këtij ligji apo i ndonjë ligji tjetër që përcakton regjim të veçantë tatimor.

8. “Veprimtari ekonomike” është çdo aktivitet ekonomik me qëllim realizimin e fitimit. Ai përfshin veprimtaritë e individëve të vetëpunësuar, individëve tregtarë dhe entiteteve.

9. “I punësuar” është një person fizik, i cili merr të ardhura nga punësimi.

10. “Punëdhënës” është personi që i jep një personi tjetër një punë apo detyrë përkundrejt pagesës në respektim të legjislacionit në fuqi dhe që mbart përgjegjësinë dhe riskun në lidhje me realizimin e punës.

11. “Qarkullim” është totali i të ardhurave të realizuara nga shitjet e mallrave dhe shërbimeve (pa përfshirë TVSH-në).

12. “Pensione private” janë pensionet e marra nga një plan pensioni sipas kushteve të legjislacionit në fuqi për fondet e pensioneve private dhe fondet e pensionit privat të krijuar me ligj të veçantë, përveç pensionit të paguar nga skema e kontributeve të detyrueshme.

13. “Person i lidhur” është çdo person që është i lidhur me një person tjetër në një marrëdhënie që ndikon direkt ose indirekt në përcaktimin e bazës tatimore, nëpërmjet menaxhimit, kontrollit apo pronësisë. Dy persona janë të lidhur nëse njëri ose të dy personat do të vepronin sipas udhëzimeve, kërkesave, sugjerimeve ose vullnetit të personit tjetër ose të një personi të tretë.

Personat e mëposhtëm trajtohen si persona të lidhur:

a) bashkëshort e bashkëshorte, bashkëjetues e bashkëjetuese, pasardhës dhe paraardhës në shkallë të parë.

b) një njësi ekonomike në të cilën çdo person zotëron direkt ose indirekt të paktën 50 për qind të të drejtave të votës ose të menaxhimit, të drejtave të shpërndarjes së dividendit ose të drejtave të kapitalit.

c) çdo dy ose më shumë entitete në të cilat një person tjetër zotëron ose mban të paktën 50 për qind të të drejtave të votës ose të menaxhimit, të drejtave të shpërndarjes së dividendit ose të drejtave të kapitalit në të dy njësitë ekonomike.

Kur zbatohen shkronjat "a" ose "b" të kësaj pike, zotërimi që i atribuohet një personi nga një person i lidhur nuk mund t'i atribuohet një personi tjetër të lidhur. Dy persona nuk do të konsiderohen të lidhur vetëm sepse njëri prej tyre konsiderohet punëtor ose klient i personit tjetër, ose të dy konsiderohen punëtorë ose klient i një personi të tretë, përveç rastit kur një marrëdhënie e tillë ndikon në përcaktimin e bazës tatimore, drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte.

14. "Palë të pavarura" janë palët që nuk janë të lidhura.

15. "Shërbim teknik" nënkupton furnizimin e jo mallrave përkundrejt një pagese qoftë në mënyrë periodike apo në një shumë të vetme, përfshirë tarifat për shërbime teknike dhe tarifat e shërbimeve të automatizuara digjitale, në masën në të cilën është e arsyeshme që t'i atribuohet çdo lloj shërbimi ose ndonjë përfitimi tjetër ofruar nga një biznes i një personi. Rastet e mëposhtme nuk konsiderohen shërbime teknike apo tarifa të lidhura me një shërbim teknik:

a) shpenzimet administrative të mbikëqyrjes dhe kontrollit, të transferuara nga një seli qendrore jashtë territorit shqiptar dhe për llogari të një selie të përhershme që vepron në Republikën e Shqipërisë;

b) transporti i pasagjerëve ose transporti i mallrave;

c) tarifat e sigurimit;

ç) akomodimi në hotele apo në vende të tjera.

16. "Tarifë shërbimi teknik" është një pagesë për shërbime menaxhimi, teknike apo konsulence, përfshirë tarifa për ofrimin e shërbimeve të teknikëve apo personelit tjetër, një pagesë për furnizimin e njohurive teknike, industriale, tregtare apo shkencore, eksperiencës apo aftësive apo një pagesë për furnizimin e asistencës që ndihmon çështjet e referuara në pikën 21 të këtij neni.

17. "Tarifë për shërbimin digjital automatik" është një pagesë për çdo shërbim të ofruar në internet ose nga një rrjet elektronik që kërkon përfshirje minimale njerëzore nga ofruesi i shërbimit.

18. "Tituj" është instrumenti financiar që përmban vlerë dhe që mund të tregtohet ndërmjet palëve, përfshirë rastet e mëposhtme:

a) aksione ose kuota në çdo shoqëri;

b) aksione ose kuota ose pjesëmarrje në partneritet;

c) bono dhe obligacione të thesarit, si dhe obligacione të korporatave;

ç) instrumentet derivative, siç përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ose që e marrin kuptimin e tyre nga parimet e kontabilitetit;

d) instrumentet në monedha të huaja, siç përcaktohet nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi ose që e marrin kuptimin e tyre nga parimet përgjithësisht të pranuara të kontabilitetit.

19. "Dividend" përfshin llojet e mëposhtme të të ardhurave, pavarësisht nëse këta dividendë janë realizuar brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë dhe pavarësisht nga mënyra se si këta dividendë janë shpërndarë:

a) të ardhurat nga aksionet ose kuotat në çdo shoqëri, aksionet e themeluesit ose të drejta të tjera të ndarjes së fitimit që nuk përbëjnë pretendime ndaj borxheve;

b) të ardhura nga të drejta të tjera të korporatës duke përfshirë dividendët për njësi dhe dividendët e ndërmjetëm;

c) të ardhurat nga shpërndarja e fitimit në ortakëri;

ç) të ardhura nga çdo lloj shpërndarjeje fitimi nga çdo lloj entiteti me përjashtim të shoqërive të thjeshta, të cilat funksionojnë sipas përcaktimeve të Kodit Civil;

d) shumat e marra nga procesi i likuidimit, në masën që tejkalojnë kapitalin e kontribuar në mjete monetare ose në natyrë;

dh) shumat e marra nga reduktimi i kapitalit, në masën që kapitali i atribuohet fitimit të pashpërndarë të kapitalizuar.

20. "Interes" konsiderohen shpenzimet e interesit për të gjitha format e borxhit, kosto të tjera ekonomikisht të barasvlershme me interesin dhe shpenzimet e bëra në lidhje me rritjen e financimit, përfshirë pagesat për huat me pjesëmarrje në fitim, interesin në obligacione, elementin e kostos financiare të pagesave të qirasë financiare, interesin e kapitalizuar ose amortizimin e interesit të kapitalizuar, shumat e interesit sipas instrumenteve derivative ose marrëveshjeve mbrojtëse, tarifat e garancisë dhe marrëveshjeve dhe kosto të ngjashme që lidhen me huamarrjen e fondeve.

21. “Honorare” janë pagesat për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të një aktivi jomaterial dhe përfshijnë sa vijon:

a) përdorimin ose të drejtën për të përdorur një të drejtë autori të veprës letrare, artistike ose shkencore, duke përfshirë filmat ose regjistrimet video ose audio, pavarësisht nëse vepra është në format elektronik ose ndryshe;

b) përdorimin ose të drejtën për të përdorur një patentë, licencë, shpikje, markë tregtare, dizajn ose model, plan, formulë ose proces sekret, ose pronë apo të drejtë tjetër të ngjashme;

c) marrjen ose të drejtën për të marrë çdo imazh ose tingull vizual ose të dyja të transmetuara me satelit, kabllo, fibër optike ose teknologji të ngjashme në lidhje me transmetimin televiziv, radio ose në internet;

ç) përdorimin ose të drejtën për të përdorur informacione në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore;

d) një shtyrje pagese, totale ose e pjesshme në lidhje me shkronjat “a” deri “ç” të kësaj pike;

dh) një prim ose shumë e ngjashme në lidhje me rastet e listuara në shkronjat “a” deri “ç” të kësaj pike.

22. “Agjent i mbajtjes së tatimit në burim”, përfshirë edhe “agjentin e tatimit në burim të listëpagesës” nënkupton çdo person që është i detyruar të mbajë tatimin në burim dhe ta transferojë atë në buxhetin e shtetit sipas parashikimeve të këtij ligji.

23. “Tatimi mbi të ardhurat e korporatës” është tatimi që paguajnë entitetet sipas dispozitave të këtij ligji.

24. “Mjet virtual” është një pasqyrim digjital i një vlere që mund të depozitohet, të tregtohet apo të transferohet në formë digjitale, si dhe që mund të përdoret për qëllime pagesash ose investimesh apo si mjet shkëmbimi, duke përfshirë, por pa u kufizuar te kriptomonedha. Në këtë përkufizim nuk përfshihen pasqyrimet digjitale të monedhave të njohura zyrtarisht si të nxjerra ose të garantuara nga bankat qendrore ose një autoritet publik, të titujve dhe mjeteve të tjera financiare që janë parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

25. “Nxjerrja apo përfitimi i mjeteve virtuale” (*Mining*) është veprimtaria e përdorimit të fuqisë kompjuterike të përdoruesve të sistemit për zgjidhjen e algoritmeve kriptografike, me qëllim konfirmimin e transaksioneve dhe përfitimin e mjeteve virtuale në këmbim, si dhe veprimtaria e përpunimit dhe konfirmimit të transaksioneve përmes investimit të një mjeti virtual të caktuar nga ana e përdoruesve të nyjave kompjuterike pjesëmarrëse në këtë proces.

26. “Instrument financiar” ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit.

Neni 4

Burimi i të ardhurave

Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë përfshijnë, por pa u kufizuar në si më poshtë:

a) të ardhurat në lidhje me punësimin, si dhe të ardhurat nga pagesat e tarifave për shërbimet e kryera në Republikën e Shqipërisë;

b) të ardhurat nga veprimtari kulturore, artistike ose sportive të kryera në Republikën e Shqipërisë;

c) të ardhurat që janë detyrim për t’u paguar nga një punëdhënës rezident, edhe nëse puna kryhet jashtë vendit;

ç) të ardhurat nga veprimtaria e biznesit dhe të ardhurat e individëve tregtarë dhe të vetëpunësuar për veprimtari dhe shërbime të ofruara në Republikën e Shqipërisë;

d) të ardhura nga biznesi që i atribuohen një selie të përhershme në Republikën e Shqipërisë;

dh) përveç të ardhurave të parashikuara në shkronjën “d” të këtij neni, edhe të ardhurat nga:

i. pasuria e paluajtshme, aksesorët dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat që rrjedhin nga të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë;

ii. të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerale, të drejtat për shfrytëzimin e pasurive hidrokarbure ose të drejta të tjera për shfrytëzimin e burimeve natyrore tokësore dhe ujore, përfshirë detin në Republikën e Shqipërisë, si dhe informacionit që u përket këtyre të drejtave;

iii. të ardhurat nga zotërimi i pasurisë së luajtshme të vendosur në Republikën e Shqipërisë.

Të drejtat dhe informacioni sipas nënndarjeve "i" dhe "ii" të kësaj shkronje, për qëllime të këtij ligji trajtohen si pasuri e paluajtshme.

e) të ardhurat nga tjetërsimi i:

i. pasurisë, të drejtave dhe informacioni i përcaktuar në shkronjën "dh" të këtij neni;

ii. aksioneve ose interesave të ngjashëm të tillë si interesat në ortakëri ose truste, sipas përkufizimeve në legjislacionin në fuqi për këtë qëllim, kudo që ndodhen, në qoftë se në çdo kohë gjatë 365 ditëve para tjetërsimit, këtyre aksioneve ose interesave të ngjashëm u buron më shumë se 50 për qind e vlerës direkt ose indirekt nga pasuria e paluajtshme, të drejtat ose informacioni, të përcaktuara në shkronjën "dh" të këtij neni.

ë) dividendët, përfshirë ata nga ortakëritë, të shpërndarë nga një person rezident;

f) fitimet kapitale nga tjetërsimi i aksioneve të entiteteve rezidente dhe çdo titulli apo instrumenti financiar në Republikën e Shqipërisë;

g) interesat e paguara nga organet e qeverisjes vendore ose qendrore, nga një tatimpagues rezident ose nga një seli e përhershme në Republikën e Shqipërisë;

gj) qiratë, kontratat e qirasë, tarifat e licencës, tarifat e shërbimit teknik dhe/ose digjital automatik, si dhe honoraret që paguhen nga një person rezident ose nga një seli e përhershme në Republikën e Shqipërisë;

h) fitimet nga lojërat e fatit për një tatimpagues rezident apo jorezident ose të paguara nga një seli e përhershme në Republikën e Shqipërisë, të ardhurat nga trashëgimitë dhe nga dhurimet e marra nga asete të ndodhura në Republikën e Shqipërisë;

i) të ardhurat nga nxjerrja apo përfitimi i mjeteve virtuale nga një person rezident në Republikën e Shqipërisë;

j) të ardhurat nga transaksionet me mjete virtuale nga një person rezident në Republikën e Shqipërisë;

k) të ardhurat nga çdo veprimtari tjetër që kryhet fizikisht në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5

Selia e përhershme

1. Seli e përhershme nënkupton një vend të caktuar biznesi, ku zhvillohet tërësisht ose pjesërisht veprimtaria e biznesit të një personi jorezident.

2. Selia e përhershme përfshin veçanërisht:

a) një vend administrimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

ç) një fabrikë;

d) një punishte;

dh) një minierë, një pus nafte ose gazi, një gurore ose çdo vend tjetër për nxjerrjen e burimeve natyrore;

e) një ndërtesë ose një kantier ndërtimi, instalimi ose projekti montimi ose çdo aktivitet mbikëqyrës të lidhur vetëm nëse një kantier, projekt ose aktivitet i tillë vazhdon në Republikën e Shqipërisë për një periudhë ose periudha në total prej më shumë se gjashtë muajsh gjatë çdo periudhe dymbëdhjetëmujore;

ë) çdo aktivitet, duke përfshirë përdorimin ose instalimin e pajisjeve të konsiderueshme të kryera në Republikën e Shqipërisë në lidhje me kërkimin, nxjerrjen ose shfrytëzimin e burimeve natyrore për një periudhë ose periudha në total prej më shumë se tre muajsh gjatë çdo periudhe dymbëdhjetëmujore;

f) kryerja e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës të ofruara nga një person jorezident nëpërmjet punonjësve të tij ose individëve të tjerë, vetëm nëse këto aktivitete vazhdojnë (për të njëjtin person ose një person të lidhur) në Republikën e Shqipërisë për një periudhë ose periudha në total prej më shumë se gjashtë muajsh gjatë çdo periudhe dymbëdhjetë mujore.

3. Pavarësisht nga pikat 1 dhe 2 të këtij neni, termi "seli e përhershme" nuk përfshin:

a) përdorimin e objekteve vetëm për qëllim të ruajtjes, ekspozimit ose dërgimit të mallrave që i përkasin personit jorezident;

b) mbajtjen e një stoku mallrash që i përkasin personit jorezident vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje;

c) mbajtjen e një stoku mallrash që i përkasin personit jorezident vetëm për qëllime përpunimi nga një person tjetër;

ç) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllimin e blerjes së mallrave ose të mbledhjes së informacionit për personin jorezident;

d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllimin e ushtrimit të çdo veprimtarie tjetër për personin jorezident;

dh) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për kombinimin e aktiviteteve të përcaktuara në shkronjat "a" deri "d" të kësaj pike, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit fiks të biznesit të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

4. Pika 3 e këtij neni nuk zbatohet për një vend fiks biznesi, që përdoret ose mirëmbahet nga një person jorezident nëse i njëjti person ose një person i lidhur ngushtësisht me të ushtron aktivitete biznesi në të njëjtin vend ose në një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë, dhe:

a) ai vend ose një vend tjetër përbën një seli të përhershme për personin ose personin e lidhur ngushtësisht sipas parashikimeve të këtij neni, ose

b) aktiviteti i përgjithshëm që rezulton nga kombinimi i aktiviteteve të kryera nga të dy personat në të njëjtin vend ose nga i njëjti person ose nga personat e lidhur ngushtësisht në të dyja vendet, nuk është i një karakteri përgatitor ose ndihmës, me kushtin që aktivitetet e biznesit të kryera nga të dy personat në të njëjtin vend, ose nga i njëjti person ose person i lidhur ngushtësisht në të dyja vendet, përbëjnë funksione plotësuese që janë pjesë e një operacioni të lidhur biznesi.

5. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij neni, por në zbatim të parashikimeve të pikës 7 të këtij neni, kur një person vepron në Republikën e Shqipërisë në emër të një personi jorezident, personi jorezident konsiderohet se ka një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë në lidhje me çdo aktivitet që ai person ndërmerr, nëse një person i tillë:

a) lidh zakonisht kontrata, ose zakonisht luan rolin kryesor në lidhjen e kontratave që lidhen në mënyrë rutinore pa modifikime materiale nga personi jorezident dhe këto kontrata janë:

i. në emër të personit jorezident, ose

ii. për transferimin e pronësisë ose për dhënien e të drejtës së përdorimit të pronës në pronësi të personit jorezident ose që personi jorezident ka të drejtën e përdorimit, ose

iii. për ofrimin e shërbimeve nga personi jorezident, përveç nëse aktivitetet e një personi të tillë janë të kufizuara në ato të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk do ta bëjnë atë vend fiks biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të pikës 4 të këtij neni; ose

b) personi zakonisht nuk lidh kontrata, as luan rolin kryesor për lidhjen e kontratave të tilla, por mban një stok mallrash ose produkti tregtar nga të cilat personi dorëzon rregullisht mallra ose produkt në emër të personit jorezident.

6. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, por në përputhje me pikën 7 të këtij neni, një entitet që operon në fushën e sigurimeve të një shteti tjetër, përjashtuar veprimtarinë e risigurimit, do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë nëse nëpërmjet një personi tjetër mbledh prime në Republikën e Shqipërisë ose siguron rreziqe që ndodhen në Republikën e Shqipërisë.

7. Pikat 5 dhe 6 të këtij neni nuk zbatohen kur personi që vepron në Republikën e Shqipërisë në emër të një personi jorezident, ushtron biznes në Republikën e Shqipërisë si agjent i pavarur dhe vepron për personin jorezident në rrjedhën e zakonshme të atij biznesi. Kur një person vepron

ekskluzivisht në emër të një ose më shumë personave me të cilët është i lidhur ngushtë, ky person nuk do të konsiderohet si agjent i pavarur sipas kuptimit të kësaj pike lidhur me ndonjë person të tillë.

8. Vetëm fakti që një person jorezident është person i lidhur me një person rezident në Republikën e Shqipërisë (kontrollon ose kontrollohet nga ky person rezident) nuk do të përbëjë në vetvete arsye që ky person jorezident të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Republikën ë Shqipërisë.

9. Një person konsiderohet i lidhur ngushtë me një person tjetër nëse, bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat relevante, njëri ka kontroll mbi tjetrin ose të dy janë nën kontrollin e të njëjtëve persona. Në çdo rast, një person do të konsiderohet se është i lidhur ngushtë me një person tjetër nëse njëri zotëron direkt ose indirekt të paktën 50 për qind të interesit përfitues në tjetrin (ose, në rastin e një shoqërie, jo më pak se 50 për qind të votës dhe vlerës së përgjithshme e aksioneve të shoqërisë ose e interesit të kapitalit të dobishëm në shoqëri) ose nëse një person tjetër zotëron direkt ose indirekt jo më pak se 50 për qind të interesit përfitues (ose, në rastin e një shoqërie, jo më pak se 50 për qind të votës dhe vlerës së përgjithshme të aksioneve të shoqërisë ose të interesit të kapitalit të dobishëm në shoqëri) të personit ose të të dy personave.

Neni 6
Viti tatimor

Viti tatimor fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik.

KREU II
TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE

KAPITULLI 1
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT PERSONALE

Neni 7
Tatimpaguesi i tatimit mbi të ardhurat personale

Çdo person fizik konsiderohet tatimpagues në kuptim të këtij ligji dhe është përgjegjës për tatimin mbi të ardhurat personale.

Neni 8
Rezidenca

Tatimpagues rezident i tatimit mbi të ardhurat personale është çdo tatimpagues që përmbush një prej kushteve të mëposhtme:

a) ka një vendbanim të qëndrueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë vitit tatimor; ose

b) qëndron në Republikën e Shqipërisë gjatë vitit tatimor për një periudhë ose periudha që në total arrijnë në 183 ditë ose më shumë. Dita e daljes nga vendi dhe dita e hyrjes në vend do të trajtohen më vete si ditë të pranisë së tij në vend; ose

c) është shtetas i Republikës së Shqipërisë, i cili jashtë territorit të saj kryen detyrën si i punësuar apo funksionar zyrtar i qeverisë së Republikës së Shqipërisë; ose

ç) ka një dyqan, zyrë profesionale, fabrikë ose një vend tjetër ku personi fizik ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, ose ka vendbanim të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, përveç rastit kur personi fizik ka një banesë të përhershme jashtë Republikës së Shqipërisë për të gjithë vitin tatimor dhe gjithashtu nuk ka banesë të përhershme në Republikën e Shqipërisë; ose

d) ka qendrën e interesave jetike në Republikën e Shqipërisë, që nënkupton lidhje të rëndësishme personale apo ekonomike me Republikën e Shqipërisë.

Neni 9
Dokumentacioni

1. Tatimpaguesi i tatimit mbi të ardhurat personale është i detyruar të mbajë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar të dhënat e deklaruara në deklaratën e të ardhurave.
2. Çdo individ i vetëpunësuar ose tregtar, i cili nuk i nënshtrohet detyrimit ligjor për mbajtjen e kontabilitetit në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, është i detyruar të mbajë të paktën regjistrin e të ardhurave, shpenzimeve, llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve apo borxheve, sipas një strukture të thjeshtuar, siç përcaktohet në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

KAPITULLI 2
DISPOZITA TË PËRCAKTIMIT TË TË ARDHURAVE TË TATUESHME

Neni 10
E ardhura e tatueshme

1. Të ardhurat e mëposhtme konsiderohen si të ardhura të tatueshme të një tatimpaguesi të tatimit mbi të ardhurat personale:
a) të ardhura nga punësimi;
b) të ardhura nga biznesi;
c) të ardhura nga investimet.
2. Të ardhurat janë të tatueshme pavarësisht nëse paguhen në të holla ose në natyrë.
3. Të ardhurat në natyrë vlerësohen me vlerën e tregut, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në këtë ligj ose në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
4. Parimi i tregut, siç përcaktohet në nenin 44 të këtij ligji, zbatohet për transaksionet ndërmjet palëve të lidhura.

Neni 11
Të ardhura që nuk janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale

Të ardhurat e mëposhtme nuk janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale:
a) të ardhurat e përfituara si rezultat i sigurimit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
b) ndihmat ekonomike nga buxhetet publike për individët pa të ardhura ose me të ardhura të ulëta, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi;
c) të ardhurat e përjashtuara në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;
ç) kompensimet financiare të paguara për pronarët e pronave si shpërblim për shpronësimet e bëra nga shteti për interesa publike, ose ish-pronarëve për shpronësimin e pronës së tyre në të kaluarën;
d) kompensimet financiare të paguara ish-të dënuarve politikë dhe pasardhësve të tyre;
dh) shpërblimet dhe çmimet e dhëna nga institucionet shtetërore për arritje në shkencë, sport, kulturë;
e) bursat e nxënësve dhe të studentëve;
ë) përfitimet për dëmshpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, përfitimet për dëmshpërblimet nga kontrata e sigurimit, të marra në zbatim të ligjit në fuqi për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore;
f) të ardhurat nga mbështetja me grante dhe subvencione në bujqësi dhe blegtori me fonde të buxhetit të shtetit ose burime të tjera.

Neni 12
Të ardhurat nga punësimi

1. Të ardhurat nga punësimi përfshijnë:

a) pagat, shpërblimet dhe përfitimet që rrjedhin nga marrëdhënie punësimi ose të ngjashme me to, përfshirë transferimin apo huazimin e punonjësve, pavarësisht nëse këto marrëdhënie janë aktuale, të ardhshme ose të kaluara, dhe ku tatimpaguesi është i detyruar të ndjekë udhëzimet e paguesit të të ardhurave në mënyrë që të marrë pagesën apo shpërblimin;

b) shpërblimet e drejtorëve, shpërblimet si anëtar i bordit të drejtorëve ose i organit ligjor të një shoqërie, si dhe shpërblimet për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues;

c) shpërblimet dhe përfitimet e paguara nga shoqëria për ortakun e saj për punën e kryer për këtë shoqëri;

ç) të ardhurat e fituara nga një individ i vetëpunësuar nëse:

i. 80 për qind ose më shumë e të ardhurave të fituara merren direkt ose indirekt nga një klient i vetëm; ose

ii. 90 për qind ose më shumë e të ardhurave totale të fituara merren nga më pak se 3 klientë.

Shkronja "ç" nuk zbatohet nëse individi i vetëpunësuar ofron shërbime vetëm për persona jorezidentë në Republikën e Shqipërisë apo vetëm për entitete që nuk kanë një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë. Në këtë rast, i vetëpunësuari konsiderohet se realizon të ardhura nga biznesi.

2. Të ardhurat nga punësimi, përveç parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, përfshijnë edhe pagesat që kryhen në rastet e humbjes ose ndërprerjes së marrëdhënieve të punësimit.

3. Kur të ardhurat nga punësimi i paguhen një të punësuari nëpërmjet një agjenti punësimi jorezident në Republikën e Shqipërisë dhe shuma e përgjithshme e paguar përfshin tarifën e komisionit, të ardhurat nga punësimi konsiderohen të jenë së paku 80% e shumës së përgjithshme.

4. Të ardhura të përftuara nga punësimi nuk do të konsiderohen si të tilla në rastet kur:

a) vlera e ushqimeve të konsumuara, pijeve joalkoolike, pajisjet e punës, trajtimi mjekësor dhe përfitime të tjera të parashikuara, në ambientet ku operohet nga ose në emër të një punëdhënësi, janë të disponueshme për të gjithë të punësuarit në kushte të ngjashme dhe krijojnë kushte më të mira pune për të punësuarit;

b) rimbursimi i shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit dhe dietat e udhëtimit, paguhen në bazë të procedurës së përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, apo akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji;

c) kompensimet për punonjësit në rast të sëmundjeve, fatkeqësive apo vështirësive të jetesës sipas parashikimeve në legjislacionin përkatës në fuqi dhe dispozitave të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji;

ç) kontributet për sigurimin e jetës, shëndetit dhe aksidenteve në punë;

d) të ardhurat që rrjedhin nga pagat dhe kompensimet për marrëdhëniet e punës të zyrtarëve të konsullatave, diplomatët, ose të ngjashëm të vendeve të treta dhe organizatave ndërkombëtare, të cilët gjatë kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me konventat apo marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, pranuara ose nënshkruara nga Republika e Shqipërisë apo Këshilli i Ministrave, gëzojnë statusin diplomatik.

5. Të ardhurat vjetore të tatueshme nga marrëdhëniet e punësimit përcaktohen si shuma e përgjithshme e të ardhurave të tatueshme nga punësimi, të marra nga një tatimpagues gjatë vitit tatimor.

6. Shuma e pagave dhe të ngjashme me to të paguara në një pagesë të vetme në një vit të caktuar përbëjnë të ardhura të viteve për të cilat janë paguar.

Neni 13
Të ardhurat nga biznesi

1. Të ardhurat nga biznesi përfshijnë, por pa u kufizuar vetëm në to, të ardhurat sipas shkronjave "a" deri "gj" në vijim, nëse nuk janë përcaktuar si të ardhura nga punësimi sipas nenit 12 të këtij ligji:

a) të ardhurat e një personi fizik nga çdo aktivitet i biznesit i çfarëdo lloji, duke përfshirë çdo aktivitet të individëve të vetëpunësuar ose tregtar;

b) të ardhurat nga interesi, dividendët dhe honorarët, të cilat janë efektivisht të lidhura me biznesin;

c) të ardhurat nga shitja e titujve, të cilat janë efektivisht të lidhura me biznesin;

ç) të ardhurat nga dhënia me qira e një biznesi, pavarësisht se qiradhënia i përfshin të gjitha apo një pjesë të aktiveve të trupëzuara apo të patrupëzuara;

d) të ardhurat nga shitja e çdo lloj aktivi dhe detyrimi të biznesit, përfshirë edhe shitjen e të gjithë biznesit;

dh) fitimi kapital i realizuar nga transferimi i aktiveve dhe pasiveve të biznesit në një riorganizim biznesi, siç përcaktohet në nenin 46 të këtij ligji;

e) dhuratat, grantet apo subvencionet e marra nga një person në lidhje me biznesin e tij;

ë) të ardhurat e realizuara nga personi fizik për çdo lloj tarife shërbimi teknik apo digjital automatik;

f) fitimet kapitale nga rivlerësimi i aktiveve të biznesit kur këto aktive janë dhënë si kontribut në natyrë në kapitalin e një shoqërie, qoftë në themelimin e saj apo rritjen e kapitalit;

g) të ardhurat nga nxjerrja apo përfitimi i mjeteve virtuale;

gj) ardhurat nga transaksionet me mjete virtuale, të cilat janë efektivisht të lidhura me biznesin.

2. Të ardhurat vjetore të tatueshme nga biznesi përcaktohen si shuma e përgjithshme e të ardhurave të biznesit, pakësuar me shpenzimet përkatëse të dokumentuara dhe të kryera me qëllim fitimin, ruajtjen dhe sigurimin e të ardhurave. Të ardhurat vjetore të tatueshme të biznesit llogariten në përputhje me kreun IV të këtij ligji.

Neni 14

Regjimi i veçantë për individët tregtarë dhe të vetëpunësuar

1. Personat fizikë, individ tregtar apo individ i vetëpunësuar, me qarkullim vjetor deri në 10 000 000 lekë, për qëllime të njohjes së shpenzimeve të zbritshme kanë të drejtë të zgjedhin një nga metodat e mëposhtme:

a) pranimin e një regjimi të veçantë, përmes të cilit shpenzimet e supozuara zbriten *apriori* sipas shumave të specifikuara në këtë shkronjë dhe pa iu nënshtruar kontrollit të regjistrimeve kontabël lidhur me to nga administrata tatimore;

i. 60% të të ardhurave për veprimtaritë prodhuese;

ii. 90% të të ardhurave për veprimtaritë e tregtimit me shumicë;

iii. 70% të të ardhurave për veprimtaritë e tregtimit me pakicë të mallrave dhe transportit individual;

iv. 60% të të ardhurave për veprimtaritë bare, restorante, disko etj., të kësaj natyre;

v. 50% të të ardhurave për veprimtaritë e shërbimeve, veprimtaritë artizanale dhe atyre zejtare;

vi. 30% të të ardhurave për individët e vetëpunësuar; ose

b) përllogaritjen e shpenzimeve të zbritshme bazuar në dokumentacionin dhe faturat respektive për çdo shpenzim.

2. Personat fizikë, individ tregtar apo individ i vetëpunësuar sipas pikës 1 të këtij neni zgjedhin dhe deklarojnë pranë administratës tatimore metodën të cilën do të zgjedhin. Kalimi nga një metodë në tjetrën nuk mund të bëhet më shpesh se një herë në tre vjet.

3. Përcaktimi i llojit të veprimtarive të kryera nga personat fizikë, individ tregtar apo individ i vetëpunësuar sipas pikës 1 të këtij neni bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi rregullues lidhur me këto veprimtari të kryera nga personat fizikë, individ tregtar apo individ i vetëpunësuar.

4. Personat fizikë, individ tregtar apo individ i vetëpunësuar, të cilët kanë aplikuar regjimin e veçantë sipas shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni, nuk i lejohet të kërkojë zbritje apo kompensim tjetër përveç kompensimit personal sipas nenit 22 të këtij ligji.

Neni 15

Të ardhurat nga investimet

1. Të ardhurat nga investimet, nëse nuk konsiderohen si të ardhura nga biznesi sipas nenit 13 të këtij ligji, përfshijnë të ardhurat si më poshtë:

a) të ardhurat nga interesat, dividendët dhe honoraret;

b) fitimet kapitale nga tjetërsimi i titujve apo instrumenteve financiare;

c) fitimet kapitale të realizuara nga skemat e sigurimit të jetës;

ç) kthimi i investimit nga skemat e pensionit privat;

d) fitimi kapital nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme;

dh) të ardhurat nga qiraja e pasurive të paluajtshme;

e) të ardhurat nga nxjerrja apo përfitimi i mjeteve virtuale sipas përcaktimeve të nenit 16 të këtij ligji;

ë) të ardhurat nga transaksionet me mjetet virtuale.

2. Të ardhurat si më poshtë janë të ardhura të përjashtuara të investimeve:

a) të ardhurat nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme, përveç tjetërsimit të automjeteve, aeroplanëve dhe anijeve në qoftë se ato shiten brenda më pak se 12 muajve nga blerja;

b) të ardhurat për transferimin e të drejtës së pronësisë së tokës bujqësore kur pasardhësi ligjor e mban tokën për të njëjtin qëllim dhe aktivitet;

c) të ardhurat nga interesat dhe fitimi kapital i eurobondeve të emetuara nga Republika e Shqipërisë, kur përfituesi është person fizik jorezident.

3. E ardhura nga investimet e marrë bashkërisht nga më shumë se një anëtar i familjes konsiderohet si e ardhur për anëtarin e familjes me të ardhura më të larta vjetore të tatueshme.

Neni 16

Të ardhurat e tatueshme nga investimi për tjetërsimin e titujve, instrumenteve financiare dhe mjeteve virtuale

1. E ardhura e tatueshme e investimit nga tjetërsimi i titujve apo instrumenteve financiare përcaktohet si diferencë ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së këtyre aseteve të tjetërsuara. Çdo shpenzim që lidhet drejtpërdrejt me blerjen dhe shitjen e titujve apo instrumenteve financiare përfshihet në çmimin e blerjes dhe në çmimin e shitjes dhe nuk shtohet apo zbritet përkatësisht.

2. Nëse të ardhurat e tatueshme nga tjetërsimi i titujve apo instrumenteve financiare rezultojnë me humbje në një vit tatimor, një humbje e tillë mund të kompensohet me të ardhura të tatueshme të investimeve nga tjetërsimi i titujve apo instrumenteve financiare të tjera në të njëjtin vit tatimor.

3. E ardhura e tatueshme e investimit nga tjetërsimi i mjeteve virtuale përcaktohet si diferencë midis vlerës në shitje dhe vlerës në blerje të këtyre mjeteve. Nëse të ardhurat e tatueshme të investimit nga tjetërsimi i mjeteve virtuale rezultojnë me humbje në një vit tatimor, të ardhurat e tatueshme të investimit konsiderohen të jenë zero.

4. Për titujt apo instrumentet financiare të listuara në bursë, çmimet e blerjes dhe të shitjes përcaktohen nga dokumentet përkatëse të tregtimit në datën e shitjes.

5. Në rastin e titujve apo instrumenteve financiare të fituara me trashëgimi ose dhurim, çmimi i blerjes për qëllime tatimore është vlera e tatueshme e titujve apo instrumenteve financiare të dhuruara ose të trashëguara në momentin e përfitimit.

6. Tjetërsimi i titujve përfshin kontributin në natyrë të titujve si kapital fillestar ose një rritje kapitali të një entiteti.

7. Ministri përgjegjës për financat miraton me udhëzim rregullat e përgjithshme dhe mënyrën e llogaritjes për zbatimin e këtij neni.

Neni 17

Të ardhurat e tatueshme nga investimi për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme

1. Të ardhurat e tatueshme të investimeve nga tjetërsimi i pasurisë përcaktohen si diferencë midis çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së pasurisë.

2. Çmimi i blerjes në lidhje me të ardhurat e patatueshme të investimit nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nuk mund të zbritet nga baza e tatimit.

3. Në rastin e pasurisë së paluajtshme, që është fituar me trashëgimi ose dhurim, ose heqje dorë nga pronësia, çmimi i blerjes për qëllime tatimore është vlera e tatueshme e pasurisë së dhuruar ose trashëguar në momentin e marrjes.

4. Nëse të ardhurat e tatueshme nga investimi sipas këtij neni rezultojnë me humbje në një vit tatimor, të ardhurat e tatueshme të investimeve nga tjetërsimi i pasurisë konsiderohen të jenë zero.

5. Çmimi i shitjes së pasurisë së paluajtshme vlerësohet me çmimin më të lartë ndërmjet çmimit të shitjes sipas kontratës dhe çmimit referues të përcaktuar në aktet në fuqi për pasurinë e paluajtshme.

6. Vlera e blerjes së tokës në rastin e shkëmbimit të së drejtës së pronësisë për tokën, me të drejtën e pronësisë së ndërtesës e cila ndërtohet në atë vend, llogaritet me çmimin e referencës së tokës për metër katror të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave për qytetet dhe zonat brenda qytetit. Çmimi i shitjes llogaritet me një referencë të vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të fituar në këmbim të tokës, duke marrë parasysh të gjitha pjesët e sipërfaqes së ndërtimit nga të cilat përfiton pronari i tokës. Shkëmbimi i truallit me sipërfaqe ndërtimi, në bazë të një kontrate shkëmbimi, nuk përbën moment për llogaritje të ndonjë fitimi kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme. Metodologjia për llogaritjen e çmimit të blerjes dhe të shitjes përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Tatimi mbi të ardhurat personale në lidhje me të ardhurat nga investimet nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme duhet të paguhet nga personi fizik që transferon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para regjistrimit të pasurive të mësipërme në regjistrin e pasurive të paluajtshme, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse. Institucioni përgjegjës i regjistrit të pasurive të paluajtshme nuk regjistron pasurinë e paluajtshme derisa pagesa e tatimit të jetë konfirmuar. Institucioni përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme transferon brenda datës 20 të muajit të ardhshëm në llogarinë e administratës tatimore tatimin e mbledhur në përputhje me dispozitat e këtij neni.

8. Ministri përgjegjës për financat dhe institucioni që ka në fushën e përgjegjësisë regjistrimin e pasurive të paluajtshme përcaktojnë me udhëzim të përbashkët kushtet, procedurat dhe metodologjinë për zbatimin e këtij neni.

Neni 18

Të ardhurat vjetore të tatueshme nga investimi

Të ardhurat vjetore të tatueshme nga investimi përcaktohen si shuma e përgjithshme e të ardhurave të tatueshme nga investimi.

Neni 19

Rregullat për entitetet e huaja të kontrolluara

1. Kur një person fizik ka një interes në një entitet të huaj të kontrolluar, fitimet e të cilit nuk i nënshtrohen tatimit ose janë të përjashtuara nga tatimi në Republikën e Shqipërisë, çdo fitim i pashpërndarë, i cili rrjedh nga të ardhurat pasive, duhet të përfshihet në të ardhurat e tatueshme nga investimi i personit fizik.

2. Çdo entitet i huaj konsiderohet entitet i huaj i kontrolluar kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) personi fizik ose së bashku me personat e lidhur ka një pjesëmarrje direkte ose indirekte prej më shumë se 50 për qind të të drejtave të votës, ose zotëron direkt ose indirekt më shumë se 50 për qind të kapitalit, ose gëzon të drejtën të marrë më shumë se 50 për qind të fitimit të atij entiteti; dhe

b) tatimi aktual i paguar mbi fitimin e tij nga entiteti është më pak se 50 për qind e tatimit që do t'i ngarkohej entitetit në rast se do të kishte qenë një entitet rezident në Republikën e Shqipërisë.

3. Fitimet e mëposhtme konsiderohen se rrjedhin nga të ardhura pasive:

a) interesat ose çdo e ardhur e realizuar nga aktivet financiare;

b) honoraret ose çdo e ardhur tjetër e realizuar nga pronësia intelektuale;

c) dividendët dhe të ardhurat nga shitja e titujve;

ç) të ardhurat nga qiraja financiare.

4. Nëse të ardhurat pasive nuk kalojnë 30 për qind të fitimit total të entitetit të kontrolluar të huaj, dispozitat e këtij neni nuk zbatohen.

5. Kur entiteti i shpërndan fitimet personit fizik dhe ato fitime të shpërndara përfshihen në të ardhurat e tatueshme të personit fizik, shumat e të ardhurave të përfshira më parë në bazën tatimore sipas këtij neni zbriten nga baza tatimore për llogaritjen e shumës së tatimit që u takon fitimeve të shpërndara.

6. Kur entiteti i huaj i kontrolluar ka paguar tatimin në shtetin e rezidencës ose vendbanimit mbi të ardhurat e përfshira në bazën tatimore të personit fizik sipas këtij neni, ky tatim mund të kreditohet kundrejt detyrimit të përgjithshëm tatimor. Kredia tatimore llogaritet sipas nenit 25 të këtij ligji.

7. Rregullat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në udhëzimin përkatës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat.

Neni 20

Tatimi i pensioneve private

1. Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi pensioni privat zbritet nga të ardhurat personale të tij për efekt tatimi.

2. Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me aktivet e fondit të pensionit nuk i nënshtrohen tatimit gjatë administrimit nga shoqëria administruese.

3. Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të një fondi pensioni, për efekte fiskale, nuk vlerësohen si të ardhura personale të anëtarit.

4. Kufiri maksimal mujor për lehtësitë tatimore, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, është deri në nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi.

5. Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një fond pensioni vlerësohen shpenzim operativ, deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me pagën minimale vjetore të miratuar në shkallë vendi dhe kjo shumë vlerësohet shpenzim i njohur për qëllime të tatimit mbi fitimin.

6. Tërheqja e parakohshme tatohet me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale për vlerën e plotë të aktiveve të tërhequra para kohe, përfshirë kontributet.

7. Pagesat e marra nga anëtari i fondit të pensionit në mënyrë periodike mujore tatohen vetëm për kthimin nga investimi, me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale.

8. Për anëtarët e fondit të pensionit, të cilët kanë investuar në fond kursimet e tyre individuale të taksuara më parë, tatimit për kthimin nga investimi me normën në fuqi i bëhet zbritje 10 % e detyrimit të tatimit për t'u paguar.

9. Pagesat e marra nga anëtari i fondit të pensionit në mënyrë të menjëhershme, përpara afatit të marrjes së tyre në mënyrë periodike mujore, siç parashikohet në ligjin për fondet e pensionit privat, tatohen me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale për vlerën e plotë të aktiveve të tërhequra, përfshirë kontributet.

KAPITULLI 3
BAZA TATIMORE E TË ARDHURAVE PERSONALE DHE DISPOZITA TË LLOGARITJES SË TATIMIT

Neni 21
Baza tatimore vjetore

1. Baza tatimore vjetore përbëhet nga:
a) të ardhurat vjetore të tatueshme të punësimit;
b) të ardhurat vjetore të tatueshme të biznesit;
c) të ardhurat vjetore të tatueshme të investimeve.
2. Baza tatimore vjetore zvogëlohet me kompensimet dhe zbritjet e përcaktuara sipas këtij ligji. Nëse diferenca midis të ardhurave vjetore të tatueshme dhe shumës totale të kompensimeve dhe zbritjeve është negative, baza tatimore vjetore konsiderohet të jetë zero.
3. Shuma e tatimit mbi të ardhurat e pagueshme nga një person për një vit tatimor është totali i shumave të pagueshme sipas këtij kreu për secilën deklaratë tatimore.

Neni 22
Zbritjet nga baza tatimore

1. Tatimpaguesi i të ardhurave personale me të ardhura nga punësimi dhe/ose biznesi mund të zbresë nga baza tatimore për periudhën tatimore:
a) një shumë prej 600 000 lekësh nëse të ardhurat vjetore janë deri 600 000 lekë, ose një shumë prej 50.000 lekësh në muaj nëse të ardhurat mujore janë deri në 50.000 lekë;
b) një shumë prej 420 000 lekësh nëse të ardhurat vjetore janë mbi 600 000 lekë deri në 720 000 lekë, ose një shumë prej 35.000 lekësh në muaj nëse të ardhurat mujore janë mbi 50.000 lekë deri në 60.000 lekë;
c) një shumë prej 360 000 lekësh nëse të ardhurat vjetore janë mbi 720 000 lekë, ose një shumë prej 30.000 lekësh në muaj nëse të ardhurat mujore janë mbi 60.000 lekë;
ç) një shumë kompensimi për çdo fëmijë në ngarkim të tij më pak se 18 vjeç prej 48 000 lekësh.
2. Tatimpaguesi i tatimit mbi të ardhurat personale me të ardhura vjetore të tatueshme nga punësimi dhe/ose të ardhura vjetore të tatueshme nga biznesi më pak se 1 200 000 lekë mund të zbresë, përveç shumave individuale sipas pikës 1 të këtij neni, shpenzimet korrente për arsimin e fëmijëve në ngarkim të tij, në vlerën maksimale 100 000 lekë.

Neni 23
Kërkesa për zbritje

1. Kompensimi për fëmijën në ngarkim të tij dhe shpenzimet për arsim kërkohen nga anëtari i familjes me të ardhura më të larta vjetore të tatueshme. Procedurat e detajuara për zbatimin e këtij neni përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.
2. Tatimpaguesi i të ardhurave personale me të ardhura nga punësimi, nëpërmjet deklaratës së statusit personal, mund të kërkojë zbritjet personale nga agjenti i tij tatimor i listëpagesës në bazë mujore, në vlerën prej 1/12 e shumës së përmendur në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji. Zbritja personale mund të pretendohet vetëm një herë në një vit tatimor. Tatimpaguesi, i cili kërkon zbritjen personale apo pjesë të saj, nuk mund ta kërkojë më shumë se një herë në një muaj.
3. Zbritjet e tjera përveç zbritjeve personale në përputhje me shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji, mund të kërkohen vetëm nëpërmjet deklaratës vjetore të të ardhurave.

Neni 24

Norma tatimore

1. Të ardhurat e tatueshme nga punësimi tatohen me normat progresive të mëposhtme:

Baza tatimore vjetore	*Norma tatimore*
0 – 2 040 000 lekë	13%
Mbi 2 040 000 lekë	23%

2. Të ardhurat neto të tatueshme (fitimi i tatueshëm) nga biznesi për individët tregtarë dhe të vetëpunësuarit tatohen me normat progresive të mëposhtme:

Baza tatimore vjetore	*Norma tatimore*
0 – 14 000 000 lekë	15%
Mbi 14 000 000 lekë	23%

3. Të ardhurat nga investimi tatohen me normat e mëposhtme:
a) të ardhurat nga dividentët 8%;
b) çdo zë tjetër i të ardhurave nga investimi 15%.
4. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, asnjë kosto nuk zbritet kundrejt të ardhurave nga investimi.

Neni 25
Kreditimi i tatimit të huaj

1. Nëse gjatë një viti tatimor tatimpaguesi rezident i tatimit mbi të ardhurat personale realizon të ardhura tatimore nga burime jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, tatimit për t'u paguar nga ai tatimpagues për këto të ardhura duhet t'i zbritet shuma e tatimit të paguar në një vend të huaj mbi këto të ardhura. Shuma e tatimit të huaj të pagueshëm duhet të vërtetohet nga dokumentacioni specifik i lëshuar për këtë qëllim nga vend-i/et i/e huaj-a ku janë realizuar të ardhurat dhe sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.
2. Shuma e zbritur e tatimit të huaj të paguar, e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, nuk mund të tejkalojë shumën e tatimit mbi të ardhurat personale që do të ishte e pagueshme për këto të ardhura, nëse ato do të ishin realizuar në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Kreditimi i tatimit të huaj duhet të llogaritet veçmas për secilin shtet, nëse të ardhurat realizohen nga burime të huaja në më shumë se një shtet.
4. Kreditimi i tatimit të huaj duhet të llogaritet veçmas për të ardhurat e përfshira në bazën tatimore vjetore dhe për të ardhurat vjetore nga investimi.

Neni 26
Llogaritja e tatimit të pagueshëm mbi të ardhurat personale

1. Tatimi mbi të ardhurat personale i pagueshëm llogaritet duke zbatuar normat përkatëse të përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji, për të ardhurat e tatueshme të personit dhe duke zbritur çdo:
a) kreditim tatimor të huaj në përputhje me nenin 25 të këtij ligji;
b) tatimin e mbajtur në burim në përputhje me kreun V të këtij ligji;
c) tatimin e listëpagesës të mbajtur nga agjenti i tatimit të listëpagesës gjatë vitit tatimor;
ç) parapagimet për tatimin mbi të ardhurat personale nga biznesi, të paguara gjatë vitit tatimor.
2. Llogaritja e tatimit të pagueshëm mbi të ardhurat personale nga punësimi dhe investimi bëhet veçmas nga llogaritja e tatimit të pagueshëm mbi të ardhurat personale nga biznesi.

3. Nëse diferenca e llogaritur në pikën 1 është negative, tatimpaguesi i të ardhurave personale mund të kërkojë tatimin e paguar më tepër dhe administrata tatimore do t'i kthejë atij shumën e mbipaguar jo më vonë se 60 ditë nga dorëzimi i kërkesës. Në rast se tatimpaguesi nuk kërkon kthimin e tatimit të paguar tepër mbi të ardhurat personale, kjo shumë konsiderohet pagesë në avancë për tatimin mbi të ardhurat personale të periudhës tatimore vijuese.

KREU III
TATIMI MBI TË ARDHURAT E KORPORATËS

Kapitulli 1
Dispozitat e përgjithshme për tatimin mbi të ardhurat e korporatës

Neni 27
Tatimpaguesi për tatimin mbi të ardhurat e korporatave

1. Çdo entitet i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat e korporatave, ku përfshihen kryesisht:
a) shoqëritë kolektive;
b) shoqëritë komandite;
c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar;
ç) shoqëritë aksionare; dhe
d) çdo entitet tjetër, përfshirë entitetet jorezidente, që nuk parashikohen në shkronjat "a" deri "d" të kësaj pike, përfshirë edhe entitetet që i nënshtrohen një regjimi të veçantë tatimor.
2. Entitetet e mëposhtme janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat e korporatës:
a) organet e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë, ligj ose vendim të Këshillit të Ministrave, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes qendrore;
b) Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave;
c) fondacionet ose institucionet financiare jobankare, të krijuara ose të transferuara me vendim të Këshillit të Ministrave, që synojnë mbështetjen e politikave zhvilluese të qeverisë nëpërmjet dhënies së kredive;
ç) entitetet që ushtrojnë vetëm veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, pasuria apo fitimi i të cilëve nuk përdoret për përfitimin e organizuesve apo anëtarëve të tyre;
d) organizatat e punës apo dhomat e tregtisë, industrisë ose bujqësisë, pasuria apo fitimi i të cilave nuk përdoret për përfitimin e një individi apo të një anëtari të tyre;
dh) entitetet e parashikuara në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi;
e) shtëpitë filmike të prodhimit kinematografik, të licencuara dhe të subvencionuara nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.
3. Të gjitha entitetet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, përveç shkronjave "a" dhe "b", pavarësisht nga përjashtimi i tatimit mbi të ardhurat e korporatës, janë të detyruara të dorëzojnë në organet tatimore deklaratën tatimore dhe pasqyrat e raportimit financiar në të njëjtat afate si entitetet, që i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat e korporatës.

Neni 28
Rezidenca

1. Një entitet është rezident në Republikën e Shqipërisë në një vit tatimor nëse:
a) entiteti është themeluar në Republikën e Shqipërisë, ose,
b) në çdo kohë gjatë vitit tatimor, menaxhimi dhe kontrolli i punëve të entitetit ushtrohen në Republikën e Shqipërisë.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, menaxhimi dhe kontrolli i punëve të një entiteti konsiderohet se ushtrohet në Republikën e Shqipërisë nëse mbledhjet e bordit drejtues të entitetit mbahen në Republikën e Shqipërisë ose plotësohen të paktën dy nga kushtet e mëposhtme:

a) vendimet në lidhje me drejtimin e përditshëm të entitetit merren në Republikën e Shqipërisë;

b) të paktën 50 për qind e anëtarëve të bordit ose drejtuesve të entitetit janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë;

c) të paktën 50 për qind e kapitalit ose e të drejtave të votës së entitetit zotërohen direkt ose indirekt nga persona rezidentë në Republikën e Shqipërisë.

Kapitulli 2
Dispozita specifike të tatimit mbi të ardhurat e korporatës

Neni 29
Përjashtimi në pjesëmarrje

1. Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të një entiteti rezident, dividendët e marrë përjashtohen nga e ardhura e tatueshme në qoftë se:

a) entiteti marrës ka aksione apo pjesëmarrje prej të paktën 10%, në vlerë ose në numër në kapitalin aksionar ose të drejtat e votimit të entitetit shpërndarës; dhe

b) aksionet ose pjesëmarrja minimale janë mbajtur për një periudhë të pandërprerë prej së paku 24 muajsh.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për entitetin jorezident të tatimit mbi të ardhurat e korporatës nëse pjesëmarrja ka të bëjë me veprimtaritë e biznesit të kryera nga një jorezident në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet një entiteti të krijuar në Republikën e Shqipërisë.

3. Nëse dividendët janë shpërndarë nga entiteti pagues për një entitet marrës, i cili nuk i ka mbajtur ende aksionet apo pjesëmarrjen për një periudhë 24-mujore, por që i plotëson kushtet e pikave 1, shkronja “a”, ose 2 të këtij neni, entiteti marrës mund që përkohësisht të kërkojë përjashtimin e dhënë në këto pika, me kusht që të vendosë për administratën tatimore garanci për shumën e tatimit që do të ishte e pagueshme në mungesë të atij përjashtimi. Administrata tatimore mund të tërheqë garancinë nëse entiteti marrës nuk i mban aksionet apo pjesëmarrjet minimalisht për të paktën 24 muaj. Përjashtimi bëhet i formës së prerë dhe garancia i kthehet marrësit në datën që aksionet ose pjesëmarrja është mbajtur minimalisht për 24 muaj.

Neni 30
Rregullat e kufizimit të interesit

1. Në masën e lejuar në këtë ligj, interesi është i zbritshëm ndaj të ardhurave nga veprimtaria në vitin tatimor në të cilin është realizuar deri në tridhjetë për qind (30%) të fitimeve të subjektit para interesit, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit (EBITDA).

2. Fitimi para interesit, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit (EBITDA) llogaritet duke u shtuar të ardhurave që i nënshtrohen tatimit shumat e rregulluara nga tatimi për interesat e tepërta, si dhe shumat e rregulluara nga tatimi për zhvlerësimin dhe amortizimin. Të ardhurat e përjashtuara nga tatimi përjashtohen edhe nga EBITDA e entitetit.

3. Për qëllimet e këtij neni, "interesi i tepërt" nënkupton shumën me të cilën interesi i zbritshëm i një entiteti tejkalon të ardhurat e tatueshme nga interesi dhe të ardhurat e tjera të tatueshme ekonomikisht ekuivalente që merr entiteti.

4. Interesi për të cilin refuzohet zbritja si rezultat i zbatimit të pikës 1 të këtij neni, mbartet për 5 vjetët e ardhshëm.

5. Ky nen nuk zbatohet për:

a) bankat, institucionet financiare jobankare të kredidhënies, shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë e lizingut;

b) interesat lidhur me kreditë e përdorura për financimin e një projekti afatgjatë të infrastrukturës publike ku operatori i projektit, kostot e huamarrjes, asetet dhe të ardhurat janë të gjitha në Republikën e Shqipërisë.

6. Rregullat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në udhëzimin përkatës të miratuar nga ministri përgjegjës për financat.

Neni 31

Provigjionet dhe zbritja e borxhit të keq për institucionet financiare

1. Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të institucioneve financiare, të rregulluara nga autoritetet rregullatore, lejohet zbritje për shumat që do të vendosen dhe/ose do të rrisin:

a) provigjionet teknike të detyrueshme të krijuara në zbatim të ligjit në fuqi për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit; dhe

b) provigjionet e detyrueshme për bankat tregtare dhe institucionet e tjera financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit të krijuara në përputhje me standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare dhe të certifikuara pa vërejtje nga auditues të jashtëm.

c) shpenzimet e bankave për kontributet vjetore dhe të jashtëzakonshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë, janë shpenzime të njohura në përcaktimin e fitimit të tatueshëm.

2. Zbritja e plotë e borxhit të keq lejohet nëse kushtet e mëposhtme përmbushen në të njëjtën kohë:

a) borxhi i keq, i përfshirë më parë në të ardhurat, hiqet nga kontabiliteti i entitetit;

b) janë ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme ligjore për të mbledhur borxhin; dhe

c) provigjionet e krijuara sipas pikës 1 të këtij neni duhet t'i shtohen fitimit të tatueshëm.

3. Në rastin e bankave, degëve të bankave të huaja dhe subjekteve financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë së kredidhënies, në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, fshirja e borxhit të keq, lidhur me procesin e kredidhënies, njihet si shpenzim i zbritshëm me plotësimin e këtyre kushteve:

a) në rast se kredia është e siguruar me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme:

i) 365 ditë pas depozitimit të kërkesës për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm te përmbaruesi ligjor, ose;

ii) në momentin e ekzekutimit të pasurisë të luajtshme ose të paluajtshme, cilado qoftë data më e hershme.

b) në rast se kredia nuk është e siguruar me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, 365 ditë pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit nga gjykata.

4. Kur një provigjion i borxhit të keq është aplikuar më parë në një pretendim që është vendosur apo ka marrë zgjidhje, shuma e rikuperuar duhet t'i shtohet fitimit të tatueshëm në vitin që rikuperohet, përveç nëse transferohet në lidhje me një riorganizim biznesi sipas nenit 46 të këtij ligji.

Neni 32

Transferimi i çmimeve

1. Në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, një entitet që merr pjesë në një ose më shumë transaksione të kontrolluara duhet të përcaktojë nëse kushtet e një transaksioni të kontrolluar janë në përputhje me parimin e tregut. Kur kushtet e vendosura apo të diktuara në një a më shumë transaksione të kontrolluara, të kryera nga një entitet, nuk janë në përputhje me parimin e tregut, atëherë fitimet e tatueshme të atij entiteti mund të rriten në atë masë që të jenë në përputhje me parimin e tregut.

2. Termi "transaksion i kontrolluar" nënkupton:

a) çdo transaksion midis personave të lidhur kur:

i. njëra nga palët në transaksion është rezidente dhe tjetra jorezidente;

ii. njëra nga palët në transaksion është jorezidente, e cila ka një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë, të cilës i atribuohet transaksioni, dhe pala tjetër është një tjetër palë jorezidente;

iii. njëra nga palët në transaksion është një rezidente dhe pala tjetër është një rezidente, e cila ka një seli të përhershme jashtë Republikës së Shqipërisë, së cilës i atribuohet transaksioni;

b) çdo marrëdhënie biznesi ndërmjet një jorezidenti dhe një selie të përhershme në Republikën e Shqipërisë të atij jorezidenti;

c) çdo marrëdhënie biznesi ndërmjet një rezidenti dhe selisë së përhershme të tij jashtë Republikës së Shqipërisë;

ç) çdo transaksion midis një rezidenti apo një jorezidenti që ka një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë, së cilës i atribuohet transaksioni, me një rezident të një juridiksioni të listuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

3. Kushtet e një transaksioni përfshijnë, por nuk kufizohen në treguesit financiarë të matur në zbatimin e metodës së duhur të transferimit të çmimit.

Neni 33

Krahasueshmëria

1. Një transaksion i pakontrolluar është i krahasueshëm me një transaksion të kontrolluar në rastet:

a) kur nuk ka diferenca të rëndësishme midis tyre që mund të ndikojnë materialisht treguesit financiarë që po kontrollohen, sipas metodës së përshtatshme të transferimit të çmimit; ose

b) kur ekzistojnë të tilla diferenca dhe një rregullim i arsyeshëm i bëhet treguesit financiar përkatës të transaksionit të pakontrolluar, me qëllim eliminimin e efekteve të këtyre diferencave në krahasim.

2. Për të përcaktuar nëse dy apo më shumë transaksione janë të krahasueshme, merren në konsideratë, në masën që ato janë ekonomikisht të përshtatshme për faktet dhe rrethanat e transaksionit, këta faktorë:

a) karakteristikat e pronës, mallit apo shërbimeve të transferuara;

b) funksionet e marra përsipër nga secila palë në lidhje me transaksionet, duke marrë në konsideratë asetet e përdorura dhe risqet e marra;

c) kushtet kontraktuale të transaksioneve;

ç) rrethanat ekonomike në të cilat ndodhin transaksionet; dhe

d) strategjitë e biznesit të ndjekura nga palët në lidhje me transaksionet.

Neni 34

Metodat e transferimit të çmimit

1. Përputhshmëria me parimin e tregut e një transaksioni të kontrolluar përcaktohet duke zbatuar metodën më të përshtatshme të transferimit të çmimit, sipas rrethanave të rastit, sipas përcaktimeve të bëra me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat. Përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, metoda më e përshtatshme e transferimit të çmimit zgjidhet midis metodave që vijojnë:

a) metoda e çmimit të pakontrolluar të krahasueshëm, e cila konsiston në krahasimin e çmimit të vendosur për mallra apo shërbime të transferuara në një transaksion të kontrolluar me çmimin e vendosur për mallra apo shërbime të transferuara në një transaksion të pakontrolluar të krahasueshëm;

b) metoda e çmimit të rishitjes, e cila konsiston në krahasimin e marzhit të rishitjes, që një blerës mallrash në një transaksion të kontrolluar fiton nga rishitja e asaj prone në një transaksion të pakontrolluar, me marzhin e rishitjes që fitohet në transaksione shitblerjesh të pakontrolluara të krahasueshme;

c) metoda kosto plus, e cila konsiston në krahasimin e rritjes (marzhit të fitimit) mbi kostot direkte dhe indirekte në furnizimin e mallrave e shërbimeve në një transaksion të kontrolluar me

rritjen, marzhin e fitimit të këtyre kostove direkte dhe indirekte në furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në një transaksion të pakontrolluar të krahasueshëm;

ç) metoda e marzhit neto të transaksionit, e cila konsiston në krahasimin e marzhit neto të fitimit ndaj një baze të përshtatshme, p.sh., kostot, shitjet, asetet, që një palë arrin në një transaksion të kontrolluar, me marzhin neto të fitimit ndaj së njëjtës bazë të arritur në transaksione të pakontrolluara të krahasueshme;

d) metoda e ndarjes së fitimit të transaksionit, sipas së cilës çdo personi të lidhur që merr pjesë në një transaksion të kontrolluar i alokohet pjesa e fitimit të përbashkët/humbjes që rrjedh nga ky transaksion që një person i pavarur do të fitonte nga pjesëmarrja në një transaksion të pakontrolluar të krahasueshëm.

2.Tatimpaguesi mund të aplikojë një metodë të transferimit të çmimit të ndryshme nga metodat e mësipërme, kur ai provon se asnjë nga metodat e miratuara nuk mund të përdoret në mënyrë të arsyeshme për të përcaktuar përputhshmërinë me parimin e tregut për transaksionet e kontrolluara dhe kjo metodë tjetër jep një rezultat në përputhje me parimin e tregut. Tatimpaguesi që përdor një metodë të ndryshme nga metodat e miratuara, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ka barrën e provës për të demonstruar se kërkesat janë përmbushur.

3. Për të përcaktuar përputhshmërinë me parimin e tregut për një transaksion të kontrolluar, nuk kërkohet të aplikohet më shumë se një metodë.

4. Kur një tatimpagues ka përdorur një metodë të transferimit të çmimit për të vendosur shpërblimin e transaksioneve të tij të kontrolluara dhe kjo metodë e transferimit të çmimit është në përputhje me dispozitat e këtij neni, atëherë kontrolli i administratës tatimore mbi faktin nëse kushtet e transaksioneve të kontrolluara të tatimpaguesit janë në përputhje me parimin e tregut bazohet në metodën e transferimit të çmimit të aplikuar nga tatimpaguesi.

Neni 35

Vlerësimi i transaksioneve të kontrolluara të kombinuara

Nëse një tatimpagues kryen, në rrethana të njëjta ose të ngjashme, dy ose më shumë transaksione të kontrolluara, që janë ekonomikisht të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën ose që përbëjnë një vazhdimësi/kombinim të caktuar, në mënyrë të tillë që ato nuk mund të analizohen veçmas në mënyrë të besueshme, këto transaksione mund të kombinohen:

a) për të kryer analizën e krahasueshmërisë, të përcaktuar në nenin 33 të këtij ligji; dhe

b) për të zbatuar metodat e transferimit të çmimit, të përcaktuara në nenin 34 të këtij ligji.

Neni 36

Diapazoni i treguesve të tregut

1. Diapazon tregu është një grup treguesish financiarë përkatës, ku përfshihen çmimet, marzhet apo pjesët e fitimit, të nxjerra nga zbatimi i metodës më të përshtatshme të transferimit të çmimit për një numër transaksionesh të pakontrolluara, ku secili është pothuajse njëlloj i krahasueshëm me transaksionin e kontrolluar, bazuar në një analizë krahasueshmërie të kryer në përputhje me nenin 33 të këtij ligji.

2. Një transaksion i kontrolluar ose një grup transaksionesh nuk është subjekt i rregullimeve sipas pikës 1 të nenit 32 të këtij ligji, kur treguesi financiar përkatës, që rrjedh nga transaksioni/transaksionet i/e kontrolluar/a që po testohet/testohen sipas metodës më të përshtatshme të transferimit të çmimit, është brenda diapazonit të tregut.

3. Kur treguesi financiar përkatës, i cili rrjedh nga transaksione të kontrolluara, del jashtë diapazonit të tregut, administrata tatimore mund ta rregullojë atë sipas pikës 1 të nenit 32 të këtij ligji, dhe çdo rregullim i tillë do të jetë në medianën e diapazonit të tregut, përveç rasteve kur administrata tatimore apo tatimpaguesi mund të vërtetojnë se rrethanat në atë rast garantojnë rregullimin në një pikë të ndryshme të gamës së tregut, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

Neni 37
Kërkesat për dokumentacion

1. Një tatimpagues duhet të paraqesë informacion dhe analiza të mjaftueshme për të vërtetuar se kushtet e transaksioneve të tij të kontrolluara janë në përputhje me parimet e tregut. Dokumentacioni i transferimit të çmimit duhet t'i vihet në dispozicion administratës tatimore, me kërkesë të saj, brenda 45 ditëve nga marrja e kërkesës së administratës tatimore. Përmbajtja dhe forma e dokumentacionit të transferimit të çmimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

2. Tatimpaguesit e përfshirë në transaksione të kontrolluara mbi një vlerë të përcaktuar duhet të paraqesin një njoftim apo formular vjetor për transaksionet e kontrolluara. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim kufirin apo vlerën e sipërpërmendur, formatin dhe afatin kohor për paraqitjen e informacionit mbi transaksionet e kontrolluara.

Neni 38
Rregullimet korresponduese

1. Kur në kushtet e transaksioneve të kontrolluara bëhet një rregullim nga një administratë tatimore e një vendi tjetër dhe ky rregullim rezulton në taksimin në atë vend të fitimeve për të cilat tatimpaguesi është tatuar tashmë në Republikën e Shqipërisë, dhe vendi që propozon rregullimin ka një marrëveshje me Republikën e Shqipërisë apo Këshillin e Ministrave për eliminimin e tatimit të dyfishtë, atëherë në këto kushte administrata tatimore e Republikës së Shqipërisë pas marrjes së një kërkese nga tatimpaguesi shqiptar do të kontrollojë përputhshmërinë e atij rregullimi me parimet e tregut, siç përcaktohet në nenin 44 të këtij ligji. Nëse administrata tatimore arrin në përfundimin që rregullimi është në përputhje me parimet e tregut, ajo bën rregullimet e duhura në vlerën e tatimit që i është ngarkuar tatimpaguesit shqiptar.

2. Procedura për paraqitjen e kërkesës për një rregullim korrespondues sipas këtij neni, përcaktohet në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

Neni 39
Marrëveshjet e çmimit në avancë

1. Marrëveshja e çmimit në avancë është një marrëveshje procedurale ndërmjet një ose më shumë tatimpaguesve dhe një ose më shumë administratave tatimore, me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të mundshme të transferimit të çmimeve në avancë, duke përcaktuar para transaksioneve të kontrolluara një grup kriteresh të duhura për përcaktimin e përputhshmërisë së këtyre transaksioneve me parimet e tregut.

2. Një tatimpagues mund të kërkojë që administrata tatimore të hyjë në një marrëveshje çmimi në avancë për të përcaktuar një grup të përshtatshëm kriteresh për përputhshmërinë me parimin e tregut për transaksionet e ardhshme të kontrolluara për një periudhë kohore të përcaktuar.

3. Kur administrata tatimore hyn në një marrëveshje çmimi në avancë me një tatimpagues, asnjë rregullim i transferimit të çmimit nuk bëhet sipas pikës 1 të nenit 32 të këtij ligji për transaksionet e kontrolluara që janë brenda fushës së marrëveshjes, për aq kohë sa afatet dhe kushtet e vendosura nga marrëveshja e çmimit në avancë janë plotësuar.

4. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat për miratimin e udhëzimit në lidhje me marrëveshjet e çmimit në avancë.

Kapitulli 3
Dispozitat e llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat e korporatës

Neni 40

Të ardhurat dhe llogaritja e tatimit të pagueshëm mbi të ardhurat e korporatave

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me këtë ligj, të gjitha veprimtaritë e një entiteti trajtohen si veprimtari biznesi dhe të gjitha të ardhurat e një entiteti përbëjnë të ardhura nga veprimtaria.

2. Tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat e korporatave llogaritet duke aplikuar normat e tatimit mbi të ardhurat e korporatave të përcaktuara në nenin 41 të këtij ligji për të ardhurat e tatueshme të entitetit dhe reduktohet me:

a) kreditimin e tatimit të huaj sipas nenit 42 të këtij ligji;

b) tatimin e mbajtur në burim sipas kreut V të këtij ligji;

c) paradhëniet për tatimin mbi të ardhurat e korporatave të paguara gjatë vitit tatimor.

3. Nëse diferenca e llogaritur në pikën 2 të këtij neni është negative, tatimpaguesi mund të kërkojë tatimin e tepërt dhe administrata tatimore do t'ia kthejë këtë shumë tatimpaguesit jo më vonë se 60 ditë nga data e aplikimit. Në rast se tatimpaguesi nuk e kërkon tatimin mbi të ardhurat e korporatave të paguar tepër, ky tatim konsiderohet si një pagesë paradhënie për tatimin mbi të ardhurat e korporatave të vitit tatimor pasardhës.

Neni 41

Norma tatimore

Norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është 15%. Përjashtimisht, norma tatimore për dividendët është 8%, pa zbritur asnjë kosto.

Neni 42

Kreditimi i tatimit të huaj për tatimin mbi të ardhurat nga korporatat

1. Nëse gjatë një viti tatimor entiteti rezident realizon të ardhura tatimore nga burime jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, tatimit për t'u paguar nga ai entitet për këto të ardhura duhet t'i zbritet shuma e tatimit të paguar në një vend të huaj për këto të ardhura. Shuma e tatimit të huaj të paguar vërtetohet me dokumentacionin specifik të lëshuar për këtë qëllim nga vendi i huaj ku janë realizuar të ardhurat dhe sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

2. Kreditimi i tatimit të huaj të paguar të përshkruar në pikën 1 të këtij neni nuk mund të kalojë tatimin e pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm për të ardhurat e korporatave nga burimi i huaj nëse këto të ardhura do të ishin realizuar në Republikën e Shqipërisë.

3. Kreditimi tatimor, siç përcaktohet në këtë nen, llogaritet veçmas për secilin vend të huaj, i cili është burim të ardhurash ose fitimesh, nëse e ardhura është realizuar nga burime të huaja në më shumë se një vend.

KREU IV

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME MBI PËRCAKTIMIN E FITIMIT

Neni 43

Fitimi i tatueshëm

1. Fitimi i tatueshëm përfshin çdo të ardhur të realizuar nga një person, subjekt i këtij kreu, gjatë vitit tatimor, duke zbritur shpenzimet e zbritshme.

2. Fitimi i tatueshëm dhe shpenzimet e zbritshme përcaktohen në bazë të pasqyrave financiare, të cilat përgatiten në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 44
Parimi i tregut

1.Transaksionet ndërmjet palëve të lidhura duhet të jenë në përputhje me parimin e tregut. Fitimet e tatueshme të një personi që merr pjesë në një apo më shumë transaksione të kontrolluara konsiderohen në përputhje me parimin e tregut nëse kushtet e këtyre transaksioneve nuk janë të ndryshme nga kushtet që do të ishin aplikuar ndërmjet palëve të pavarura në transaksione të krahasueshme, të kryera në rrethana të krahasueshme.

2. Më udhëzim të ministrit përgjegjës për financat, miratohen rregullat dhe procedurat për zbatimin e këtij neni.

Neni 45
Kontratat afatgjata

1. Një kontratë afatgjatë është një kontratë, e cila është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) lidhet për qëllime të prodhimit, instalimit, ndërtimit ose kryerjes së shërbimeve;

b) afati i saj tejkalon ose pritet të tejkalojë 12 muaj.

2. Të ardhurat, që lidhen me një kontratë afatgjatë, duhet të njihen nga organet përgjegjëse tatimore për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale dhe të tatimit mbi të ardhurat e korporatave, me shumën që korrespondon me pjesën e kontratës së përfunduar në vitin tatimor përkatës. Përqindja e përfundimit të kontratës përcaktohet ose duke iu referuar raportit të kostove të atij viti me shpenzimet e përgjithshme të vlerësuara ose duke iu referuar standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit.

3. Shpenzimet e zbritshme tatimore, që lidhen me kontratat afatgjata, merren parasysh në vitin tatimor në të cilën ato kryhen në përputhje me standardet kontabile që përcaktohen sipas urdhrit të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 46
Rregullat e zbatueshme mbi riorganizimet e biznesit

1. Riorganizimet e biznesit përfshijnë bashkimet, ndarjet, ndarjet e pjesshme, shkëmbimin e aksioneve dhe transferimet e degëve të veprimtarisë.

2. Një riorganizim biznesi nuk shkakton tatim të fitimeve kapitale mbi aktivet e transferuara për t'i dhënë efekt riorganizimit, përveç ndonjë pagese në para që tejkalon pagesën e cilësuar në të holla.

3. Për qëllime të këtij neni:

a) “Bashkim me përthithje” është çdo transferim nga një entitet i të gjitha veprimtarive të tij të biznesit (personi transferues) në një shoqëri (shoqëria përthithëse) në shkëmbim të emetimit apo transferimit të aksioneve ose kuotave që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë përthithëse;

b) “Transferim i një dege të veprimtarisë” është çdo operacion nëpërmjet të cilit një shoqëri (shoqëria transferuese) transferon pa u shpërbërë një ose më shumë degë të veprimtarisë të saj në një shoqëri tjetër (shoqëria përthithëse), në këmbim të emetimit ose transferimit të aksioneve ose kuotave që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë përthithëse. Një “degë e veprimtarisë” nënkupton të gjitha aktivet e pasivet e një sektori të një shoqërie, të cilat nga pikëpamja organizative përbëjnë një veprimtari të pavarur ekonomike dhe përfshin, gjithashtu, transferimin e të gjitha aktiveve e të pasiveve të një shoqërie.

c) “Shkëmbim i aksioneve ose kuotave” është çdo operacion nëpërmjet të cilit një shoqëri (shoqëria blerëse) përfiton një pjesëmarrje në kapitalin e një shoqërie tjetër (shoqëria e blerë), në këmbim të emetimit ose të transferimit tek aksionari ose ortaku i shoqërisë së blerë, në këmbim për aksionet ose kuotat e tyre, të aksioneve ose kuotave që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë së blerë dhe, nëse zbatohet, një pagesë e cilësuar në të holla, duke pasur parasysh se shoqëria blerëse merr shumicën e të drejtës së votës në shoqërinë e blerë me këtë operacion.

ç) “Shkrirje/bashkim” është çdo operacion përmes së cilit:

i. një ose më shumë shoqëri (shoqëritë transferuese), që shpërbëhen pa kaluar në procesin e likuidimit, i transferojnë të gjitha aktivet e pasivet e tyre në një tjetër shoqëri ekzistuese (shoqëria përthithëse), në këmbim të emetimit ose të transferimit tek aksionari ose ortaku të aksioneve ose kuotave që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë përthithëse dhe, nëse zbatohet, një pagesë të cilësuar në të holla; ose

ii. dy apo më shumë shoqëri (shoqëritë transferuese), që shpërbëhen pa kaluar në procesin e likuidimit, i transferojnë të gjitha aktivet e pasivet e tyre te një shoqëri që ata formojnë (shoqëria përthithëse), në këmbim të emetimit ose të transferimit tek aksionari ose ortaku të aksioneve ose kuotave që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë përthithëse dhe, nëse zbatohet, një pagesë të cilësuar në të holla; ose

iii. një shoqëri (shoqëria transferuese), që shpërbëhet pa kaluar në procesin e likuidimit, i transferon të gjitha aktivet e pasivet e saj te shoqëria (shoqëria përthithëse) dhe mban të gjitha aksionet ose kuotat që përfaqësojnë kapitalin e saj.

d) “Ndarje” është çdo operacion përmes të cilit:

i. një shoqëri (shoqëria transferuese), që shpërbëhet pa kaluar në proces likuidimi, transferon të gjitha aktivet e pasivet të dy apo më shumë shoqëri ekzistuese ose të reja (shoqëri pritëse), në këmbim të emetimit të aksioneve ose kuotave proporcionale ose të transferimit tek aksionari ose ortaku i saj të aksioneve ose kuotave që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë pritëse dhe, nëse zbatohet, një pagesë të cilësuar në të holla; ose

ii. një shoqëri (shoqëria transferuese) transferon një ose më shumë degë të veprimtarisë të një shoqëri që ajo formon (shoqëria pritëse), në këmbim për emetimin ose transferimin tek aksionari ose ortaku të aksioneve ose kuotave që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë pritëse dhe, nëse zbatohet, një pagesë të cilësuar në të holla.

dh) “Pagesë e cilësuar në të holla” është pagesa në të holla që bëhet nga një shoqëri përthithëse ose blerëse, përveç emetimit ose transferimit të aksioneve ose kuotave, që nuk i tejkalojnë në total 10% të vlerës nominale të aksioneve ose kuotave të emetuara ose të transferuara në këmbim.

e) “Vlerë për qëllime tatimore” nënkupton vlerën mbi bazën e së cilës çdo fitim ose humbje do të ishte llogaritur për qëllime të tatimit mbi të ardhurat, fitimet ose fitimet kapitale të shoqërisë transferuese nëse këto aktive ose detyrime do të ishin shitur në momentin e riorganizimit, por në mënyrë të pavarur prej tij.

4. Shoqëria që merr aktive gjatë riorganizimit të biznesit:

a) vlerëson aktivet dhe detyrimet e marra me vlerën e tyre kontabël në shoqërinë transferuese në momentin e riorganizimit;

b) zhvlerëson aktivet e biznesit sipas rregullave që do të zbatoheshin për shoqërinë transferuese sikur të mos kishte ndodhur riorganizimi;

c) mbart rezervat dhe provigjionet e krijuara nga shoqëria transferuese, në varësi të kushteve që do të zbatoheshin për shoqërinë transferuese sikur të mos kishte ndodhur riorganizimi. Shoqëria marrëse merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë transferuese në lidhje me rezervat dhe provigjionet e tilla.

5. Në rastin e transferimit të një dege veprimtarie, shoqëria transferuese përjashtohet nga tatimi për fitimet kapitale të realizuara për shkak të riorganizimit, përveç çdo pagese në para që tejkalon pagesën e cilësuar në të holla. Shoqëria transferuese u atribuon titujve të marrë nga riorganizimi i biznesit vlerën e tyre të tregut në momentin e riorganizimit. Nëse shoqëria transferuese shet letrat me vlerë të marra brenda tre vjetëve nga riorganizimi i biznesit, kostoja e blerjes për llogaritjen e fitimeve kapitale do të jetë më e ulët se:

a) vlera e tregut të letrave me vlerë në momentin e riorganizimit; dhe

b) vlerat kontabël kumulative të aktiveve dhe detyrimeve të transferuara për shkak të riorganizimit, ashtu siç ishin në shoqërinë transferuese përpara riorganizimit.

6. Në rastin e bashkimit, ndarjes ose shkëmbimit të aksioneve, aksionari ose ortaku i shoqërisë transferuese:

a) nuk i nënshtrohet tatimit në lidhje me ndonjë fitim kapital të realizuar për shkak të riorganizimit, me përjashtim të çdo pagese në para që tejkalon pagesën e cilësuar në të holla;

b) aksionarët ose ortakët nuk u atribuojnë titujve që marrin në këmbim një vlerë për qëllime tatimore më të madhe se vlera e titujve që ata mbanin menjëherë përpara riorganizimit.

7. Ky nen zbatohet vetëm për transferimin e një dege ose degësh aktiviteti që ndodhen në Republikën e Shqipërisë, nëse shoqëria ose personi transferues dhe shoqëria marrëse janë të dy rezidentë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 47

Tatimi i llogaritur për transferimin e aktiveve të biznesit

1. Transferimi i aktiveve të biznesit konsiderohet i tatueshëm në rastet e mëposhtme:

a) një tatimpagues rezident transferon aktivet e biznesit nga zyra qendrore e tij vendase në një seli të përhershme jashtë vendit dhe Republika e Shqipërisë nuk ka më të drejtë të tatojë aktivet e transferuara të biznesit për shkak të transferimit;

b) një tatimpagues rezident transferon rezidencën e tij tatimore në një vend tjetër, me përjashtim të atyre aktiveve të biznesit që mbeten efektivisht të lidhura me një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë.

2. Baza e tatueshme që do t'i nënshtrohet tatimit është shuma e barabartë me vlerën e tregut të aktiveve të transferuara të biznesit minus vlerën e tyre për qëllime tatimore në momentin e daljes së aktiveve të biznesit.

3. Kur transferimi i aktiveve të biznesit ose i rezidencës tatimore bëhet në Republikën e Shqipërisë, Republika e Shqipërisë pranon vlerën e tregut në hyrje si vlerën fillestare të aktiveve të biznesit për qëllime tatimore.

4. Për qëllime të pikave 1 deri në 3 të këtij neni, termi "vlerë tregu" është shuma me të cilën mund të shkëmbehet një aktiv biznesi ose mund të vendosen me vullnet detyrimet e ndërsjella midis blerësve dhe shitësve të palidhur në një transaksion të drejtpërdrejtë.

Neni 48

Shpenzimet e zbritshme

Shpenzimet e zbritshme janë të gjitha shpenzimet e kryera nga një person që i nënshtrohet këtij ligji gjatë vitit tatimor, në masën që këto shpenzime për blerje mallrash apo shërbimesh kryhen realisht për qëllim të realizimit të fitimit dhe në interes të biznesit, që janë të dokumentuara nga tatimpaguesi dhe që nuk janë objekt i ndonjë kufizimi të përcaktuar me këtë ligj. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim mënyrën e zbatimit të këtij neni.

Neni 49

Shpenzime të zbritshme për tokën që shkëmbehet për ndërtim

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të sipërmarrjeve që operojnë në ndërtimin dhe/ose shitjen e ndërtesave për qëllime strehimi, veprimtari prodhuese, tregtare ose veprimtari të shërbimit, metodologjia për njohjen e të ardhurave nga shitja dhe shpenzimeve të veprimtarisë, si dhe konsiderimi i pjesës përfituese të pronarëve të truallit dhe vetë kostove të truallit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 50

Shpenzimet jo të zbritshme dhe kufizimi i zbritjes

1. Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të zbritshme:

a) kostot e blerjes dhe përmirësimit të tokës dhe shesheve të ndërtimit;

b) kostoja e blerjes, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të amortizueshme;

c) shpenzimet e amortizimit sipas rregullave të kontabilitetit dhe nenit 51 të këtij ligji;

ç) zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë ose të kapitalit kontribues në një partneritet;

d) dividendët për aksionarët ose ortakët, si dhe dividendët e entiteteve të tjera që i nënshtrohen këtij ligji;

dh) interesat e paguara që tejkalojnë normën mesatare vjetore të interesit 12-mujor të kredisë të vendosur nga bankat tregtare, siç publikohet zyrtarisht nga Banka e Shqipërisë, përjashtuar interesat e kredive të dhëna nga institucionet e mikrokredisë;

e) gjobat dhe dënimet që i paguhen një autoriteti publik për shkelje të legjislacionit;

ë) shpenzimet për krijimin ose rritjen e provigjioneve, rezervave apo fondeve të tjera speciale, përveç kur kjo është e përcaktuar ndryshe me këtë ligj;

f) tatimi mbi fitimin korporativ, TVSH-ja e kredituesshme, si dhe akciza e paguar nga subjektet që administrojnë mallra akcize;

g) shpenzimet e përfaqësimit dhe shpenzimet për pritje-përcjellje që tejkalojnë 0,3 për qind të të ardhurave vjetore. Për tatimpaguesit eksportues, përjashtuar prodhuesit me material porositësi, të cilët në 3 vjetët e fundit kanë realizuar mbi 70 për qind të të ardhurave nga eksporti, shpenzimet e dokumentuara, të kryera për pjesëmarrje, prezantim në panaire apo ekspozita jashtë vendit, njihen si shpenzime të zbritshme deri në masën 3 për qind të të ardhurave vjetore.

gj) shpenzimet e kryera si konsum personal nga aksionerët, ortakët, administratorët dhe familjarët e tyre;

h) shpenzimet të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore në fuqi;

i) dhuratat dhe donacionet;

j) shpenzimet për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit të faturuara nga jorezidentë, në qoftë se nuk paguhen nga tatimpaguesi brenda periudhës së dorëzimit të deklaratës tatimore. Në rast se shpenzime të tilla paguhen më vonë, ato janë të zbritshme në vitin tatimor kur ato paguhen;

k) shpenzimet për pagat, shpërblimet dhe forma të tjera të të ardhurave personale që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës, të paguara të punësuarve, duke përfshirë administratorët dhe që nuk janë bërë nëpërmjet sistemit bankar ose institucioneve të parasë elektronike të licencuara nga Banka e Shqipërisë;

l) shumat e paguara me para në dorë në tejkalim të kufijve të përcaktuar nga dispozitat e ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë;

ll) shpenzimet e sigurimit të jetës dhe shëndetit të punonjësve të tatimpaguesit që tejkalojnë 5% të pagave bruto të tyre për vitin tatimor;

m) bursat që jepen për nxënësit dhe studentët e institucionit arsimor publik dhe privat ndryshe nga ato të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;

n) shpenzimet për kontributet e bëra nga punëdhënësi në emër të punonjësve të tij në një plan pensioni privat, që tejkalojnë kufizimet e pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji;

nj) shpenzimet e lidhura me të ardhurat, të cilat nuk janë përfshirë në fitimin e tatueshëm në bazë të këtij ligji;

o) mitdhëniet dhe ryshfetet;

p) shumat e sponsorizuara:

i. që tejkalojnë masën 5 për qind të fitimit para tatimit për botuesit e shtypit dhe botimet e veprave letrare, shkencore, enciklopedike, si dhe për veprimtaritë kulturore apo artistike;

ii. që tejkalojnë masën 5 për qind të fitimit para tatimit për veprimtaritë sportive. Shumat e sponsorizuara, brenda kufirit të mësipërm për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të organizatave sportive të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës, për efekt të përllogaritjes së tatimit mbi fitimin e periudhës tatimore, janë të zbritshme sa trefishi i vlerës së shumës së sponsorizuar. Mbartja e tyre në periudhat tatimore të ardhshme nuk lejohet. Kjo zbritje lejohet pas lëshimit të "Autorizimit të sponsorizimit" nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve sipas procedurave të parashikuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat. Kjo dispozitë zbatohet vetëm për entitetet sponsorizuese, të cilat realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë,

iii. që tejkalojnë masën 3 për qind të fitimit para tatimit për sponsorizimet e veprimtarive të tjera, që nuk përfshihen në nënndarjet "i" dhe "ii" të kësaj shkronje;

q) humbjet, dëmtimet, firot dhe skarcot gjatë prodhimit, tranzitimit, magazinimit, tregtimit tej rregullave të përcaktuara në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore që janë në fuqi;

r) çdo shpenzim i pretenduar, masa e të cilit nuk vërtetohet me dokumente nga tatimpaguesi apo që nuk përfaqëson një transaksion real.

2. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim mënyrën e zbatimit të këtij neni.

Neni 51

Amortizimi

1. Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm, amortizimi për aktivet fikse të biznesit llogaritet dhe zbritet nga:

a) pronari i aktiveve të biznesit, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në shkronjën "b" të kësaj pike;

b) personi që mbart riskun për humbjen apo dëmtimin e aktiveve, në rastet e aktiveve të dhëna me qira, uzufruktit apo ndonjë forme tjetër të parashikuar me dispozita ligjore.

2. Aktivet financiare dhe aktivet fikse të trupëzuara, që nuk janë subjekt i konsumimit dhe vjetrimit, të tilla si: toka, trualli, veprat e artit, sendet antike, bizhuteritë, metalet dhe gurët e çmuar, nuk amortizohen.

3. Kostot, që lidhen me blerjet, ndërtimin ose përmirësimin e aktiveve fikse që nuk janë subjekt i amortizimit, janë të zbritshme në vitin tatimor në të cilën aktivet fikse janë tjetërsuar, me kusht që të ardhurat nga tjetërsimi janë të përfshira në fitimin e tatueshëm.

4. Amortizimi në vitin e blerjes apo të futjes në përdorim të aktivit dhe në vitin e nxjerrjes jashtë përdorimit përllogaritet në përpjesëtim me periudhën e përdorimit gjatë atij viti.

5. Amortizimi i kostove të blerjes ose ndërtimit, si dhe kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të ndërtesave, instalimeve dhe ndërtimeve, që shërbejnë për një periudhë prej më shumë se 15 vjetësh, llogaritet në mënyrë individuale për çdo aktiv me normën e amortizimit 5% të këtyre kostove për vitin tatimor.

6. Amortizimi i kostove të aktiveve jo të trupëzuara llogaritet në mënyrë individuale sipas metodës lineare për secilin aktiv në masën 15% të këtyre kostove për vitin tatimor.

7. Amortizimi për kategoritë e mëposhtme të aktiveve llogaritet në mënyrë individuale sipas metodës lineare me përqindje si më poshtë:

a) kompjuterat, sistemet e informacionit, produktet e programeve kompjuterike (*software*) dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave me 25%;

b) të gjitha aktivet e tjera të veprimtarive të biznesit me 20%.

8. Në çdo kategori të përshkruar në pikën 7, përqindja e amortizimit, e specifikuar në këtë nen, zbatohet mbi bazën e amortizimit të kategorisë përkatëse.

9. Kur një aktiv, siç është përmendur në pikat 5, 6 dhe 7, del jashtë përdorimit gjatë një viti tatimor, vlera kontabël e mbetur për qëllime tatimore është e zbritshme në atë vit, ndërkohë që të ardhurat e mundshme nga nxjerrja jashtë përdorimit të jenë përfshirë në fitimin e tatueshëm.

10. Baza e amortizimit është e barabartë me koston e blerjes ose krijimit të aktivit, duke shtuar koston e rikonstruksionit të aktiveve të kategorisë përkatëse gjatë vitit tatimor.

11. Baza e amortizimit për autoveturat 1+4 të personelit nuk mund të jetë më e lartë se 50% e kostove të blerjes dhe rikonstruksionit, përfshirë TVSH-në. Kostoja e plotë e autoveturës 1+4, e cila amortizohet 50%, nuk mund të jetë më e lartë se 10 000 000 lekë.

12. Në rastin kur baza e amortizimit është një shumë negative, kjo shumë i shtohet fitimit të tatueshëm dhe baza e amortizimit do të konsiderohet e barabartë me zero.

13. Në rastin kur baza e amortizimit nuk kalon 10 000 lekë, e gjithë baza e amortizimit do të konsiderohet një shpenzim i zbritshëm.

14. Në rastet e rivlerësimit të aktiveve të biznesit, amortizimi nuk do të lejohet për shumën e rivlerësuar.

Neni 52
Vlerësimi i inventarit

1. Tatimpaguesi duhet vazhdimisht të përdorë metodën e njëjtë kontabël për vlerësimin e inventarit, përfshirë edhe inventarin në proces. Metoda kontabël nuk mund të ndryshohet më shumë se një herë në pesë vite tatimore.

2. Zhvlerësimi dhe rivlerësimi i inventarit, pas njohjes fillestare, sipas përcaktimeve të ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, nuk njihen për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm. Ky rregull zbatohet edhe për aktivet financiare dhe aktivet jomateriale.

3. Inventari i imët amortizohet në masën 50% në vitin e blerjes së tij dhe në masën 50% në vitin pasardhës.

Neni 53
Zbritjet e borxhit të keq

1. Zbritja lejohet për një pjesë të vlerës nominale të çdo arkëtimi nga një palë e palidhur, që ishte përllogaritur si e ardhur, e cila mbetet e papaguar dhe për të cilën tatimpaguesi beson se borxhi nuk do të jetë tërësisht ose pjesërisht i likuiduar dhe tatimpaguesi ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për mbledhjen e borxhit të keq, të përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat si më poshtë:

a) deri në 20% të borxhit të keq, kur në fund të vitit tatimor borxhi i keq është i papagueshëm për më shumë se 6 muaj;

b) deri në 40% të borxhit të keq, kur në fund të vitit tatimor borxhi i keq është i papagueshëm për më shumë se 12 muaj;

c) deri në 60% të borxhit të keq, kur në fund të vitit tatimor borxhi i keq është i papagueshëm për më shumë se 24 muaj;

ç) deri në 85% të borxhit të keq, kur në fund të vitit tatimor borxhi i keq është i papagueshëm për më shumë se 36 muaj.

2. Zbritja e plotë e borxhit të keq lejohet nëse kushtet e mëposhtme përmbushen në të njëjtën kohë:

a) borxhi i keq, i përfshirë më parë në të ardhurat, hiqet nga librat kontabël të tatimpaguesit, dhe

b) tatimpaguesi ka ndërmarrë të gjithë hapat e mundshëm ligjorë për mbledhjen e borxhit të keq.

3. Kur një zbritje e një borxhi të keq është aplikuar më parë në një pretendim që është rënë dakord ose jo, shuma e rifituar duhet t'i shtohet fitimit të tatueshëm në vitin e rikuperimit të shumës, përveç rasteve kur mund të jetë transferuar në një proces riorganizimi të biznesit.

4. Ky nen nuk zbatohet për institucionet financiare (përfshirë shoqëritë e sigurimit).

Neni 54
Mbartja e humbjeve

1. Nëse fitimi i tatueshëm rezulton në humbje në një vit tatimor, një humbje e tillë mund të kompensohet me fitimet e tatueshme në pesë vjetët e ardhshëm tatimorë, sipas parimit "humbja e parë më parë se humbja e fundit".

2. Dispozitat e pikës 1 të këtij neni nuk zbatohen për humbjet e pësuara në vitin tatimor dhe vitet e mëparshme nëse ndodh një ndryshim në pronësi që tejkalon 50% të aksioneve, kuotave ose të drejtave të votës, me kusht që kjo të shoqërohet me një ndryshim të aktivitetit. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim zbatimin e këtij neni.

Neni 55
Tatimi i ndryshimit të pronësisë për sektorë të veçantë

1. Ky nen zbatohet për entitetet që:

a) zotërojnë të drejta për shfrytëzimin e pasurive minerale, të drejta për shfrytëzimin e pasurive hidrokarbure ose të drejta të tjera për shfrytëzimin e burimeve natyrore tokësore dhe ujore, përfshirë detin në Republikën e Shqipërisë, si dhe informacionit që u përket këtyre të drejtave, të cilat për qëllime të këtij ligji trajtohen si pasuri e paluajtshme;

b) ushtrojnë veprimtari në fushën e telekomunikacioneve;

c) ushtrojnë veprimtari si institucione financiare.

2. Nëse gjatë një periudhe tatimore pronësia direkte dhe/ose indirekte e kapitalit aksionar, kuotave ose e të drejtave të votimit të një entiteti të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, ndryshon me më shumë se 20% në vlerë ose numër aksionesh apo kuotash, entiteti trajtohet si të jetë duke shitur një pjesë proporcionale të të gjitha pasurive të tij menjëherë përpara ndryshimit. Entiteti trajtohet si:

a) përfitues i të ardhurave nga shitja, e barabartë kjo me pjesën proporcionale të vlerës së tregut të aktivit në atë kohë; dhe

b) riblerës i aktivit për të njëjtën vlerë.

Kjo pikë aplikohet në rastet kur entiteti për tre vjetët paraardhës ka realizuar një mesatare qarkullimi prej 500 000 000 (pesëqind milionë) lekësh.

3. Kur një entitet është subjekt i tatimit mbi të ardhurat e korporatës, sipas këtij ligji, bazuar në pikën 2 të këtij neni, çdo ndryshim pronësie i aksioneve ose interesave të ngjashëm që shkaktuan ndryshimin, është i përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat.

4. Një entitet, i cili është subjekt i një ndryshimi të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, njofton autoritetet tatimore me detajet e ndryshimit brenda 45 ditëve nga koha kur ka ndodhur ndryshimi.

5. Entiteti njofton administratën tatimore për një ndryshim pronësie të drejtpërdrejtë ose të tërthortë prej 10% ose më shumë të kapitalit të saj ose të të drejtave të votës. Ndryshimi i pronësisë duhet të jetë objekt i nënndarjes "ii" të shkronjës "e" të nenit 4 të këtij ligji. Njoftimi duhet të kryhet brenda 45 ditëve nga ndryshimi i pronësisë. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastet kur zbatohet pika 4 e këtij neni.

6. Në rast të mosnjoftimit të autoriteteve tatimore, entiteti dënohet sipas penaliteteve të përcaktuara në ligjin në fuqi për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

7. Parashikimet e këtij neni zbatohen në çdo rast, përveç kur ndryshimi i pronësisë në kapitalin aksionar, kuotat ose të drejtat e votimit të një entiteti, u nënshtrohet dispozitave të marrëveshjeve të ratifikuara për shmangien e tatimit të dyfishtë në fuqi.

KREU V
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME TË MBAJTJES SË TATIMIT NË BURIM

Neni 56
Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim

1. Çdo agjent i mbajtjes së tatimit në burim është i detyruar:

a) të mbajë tatimin kur paguan ndonjë të ardhur dhe ndonjë pagesë që është subjekt i nenit 58 të këtij ligji;

b) të transferojë shumën e saktë në afatin e kërkuar të tatimit të mbajtur në llogarinë e autoritetit kompetent tatimor, së bashku me deklaratën e tatimit të mbajtur në burim, siç parashikohet në nenin 57 të këtij ligji;

c) të mbajë regjistrime të të ardhurave dhe pagesave e të tatimit të paguar dhe t'ia vendosë në dispozicion ato autoritetit kompetent tatimor kur kërkohet nga ky i fundit për kontrollin e saktësisë së llogaritjes, mbajtjes dhe/ose pagesës së tatimit sipas këtij ligji.

2. Data e pagesës së të ardhurave, subjekt i mbajtjes së tatimit në burim, nënkupton datën në të cilën pagesa është kryer. Në rastin e dividentit, subjekt i detyrimit të mbajtjes së tatimit në burim, i cili nuk është paguar, tatimi duhet të mbahet dhe të transferohet në fund të muajit të tretë pas muajit në të cilin organi statuor i entitetit ka vendosur mbi shpërndarjen e fitimit përkatës. Entiteti

depoziton pranë organeve tatimore, jo më vonë se data 31 korrik të çdo viti, vendimin mbi destinacionin e fitimit.

3. Agjentët e mbajtjes së tatimit janë përgjegjës për pagesën e tatimit në emër të një tatimpaguesi tjetër njëlloj si të ishte detyrimi i tyre tatimor.

4. Agjenti i mbajtjes së tatimit detyrohet të deklarojë dhe të paguajë tatimin e mbajtur në llogarinë e të ardhurave të organeve tatimore deri në datën 20 të muajit që pason muajin e pagesës ose mbajtjes së tatimit, në përputhje me pikën 2 të këtij neni.

Neni 57

Deklarata e tatimit të mbajtur në burim

1. Deklarata e tatimit të mbajtur duhet të ketë të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) të dhënat identifikuese të agjentit të mbajtjes në burim;

b) të dhënat identifikuese të tatimpaguesit të cilit i mbahet tatimi;

c) rezidencën tatimore të tatimpaguesit të cilit i mbahet tatimi, në rast se tatimi mbahet në burim për një tatimpagues jorezident;

ç) llojin e të ardhurave ose pagesat;

d) shumën e tatimit të mbajtur në burim;

dh) datën e të ardhurave ose pagesave.

2. Deklarata e tatimit të mbajtur në burim nuk shërben si certifikatë e tatimit të paguar në Republikën e Shqipërisë derisa të certifikohet nga autoriteti kompetent tatimor.

3. Ministri përgjegjës për financat miraton me udhëzim formën dhe përmbajtjen e deklaratës për tatimin e mbajtur në burim.

4. Deklarata e tatimit të mbajtur në burim dorëzohet sipas kërkesave të parashikuara në ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 58

Të ardhurat dhe pagesat objekt i tatimit të mbajtur në burim

1. Të ardhurat dhe pagesat në vijim janë objekt i mbajtjes së tatimit në burim, kundrejt detyrimit tatimor përfundimtar, kur i paguhen një tatimpaguesi rezident ose një selie të përhershme në Republikën e Shqipërisë të një tatimpaguesi jorezident:

a) dividendët;

b) interesat;

c) honoraret;

ç) të ardhurat nga lojërat e fatit;

d) të ardhurat nga qiradhënia vetëm kur i paguhen individit.

2. Pagesat e mëposhtme janë subjekt i mbajtjes përfundimtare të tatimit në burim kur paguhen nga një tatimpagues rezident apo një seli e përhershme në Republikën e Shqipërisë për një person fizik jorezident ose një entitet jorezident pa një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë:

a) dividendët, interesat dhe honoraret;

b) fitimet nga lojërat e fatit;

c) pagesat e shërbimeve, përveç shërbimeve të marra fizikisht jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

ç) shërbimet e sigurimit;

d) tarifat për pjesëmarrjen në bordet drejtuese dhe këshillat ose trupa drejtues të tjerë;

dh) pagesat për ndërtime, instalime, montime ose punë mbikëqyrëse të lidhura me to;

e) pagesat për performancën e aktorëve, muzikantëve ose sportistëve, përfshirë pagesa të tilla të bëra për personat që punësojnë artistë ose sportistë ose që veprojnë si ndërmjetës në organizimin e shfaqjeve apo performancave.

3. Të ardhurat e mëposhtme nuk janë subjekt i mbajtjes së tatimit në burim:

a) të ardhurat e paguara personave të përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat;

b) dividendët sipas kushteve të përcaktuara në nenin 29 të këtij ligji;

c) të ardhurat nga fitimi kapital, si dhe të ardhurat nga interesat nga emetimi i eurobondit prej Republikës së Shqipërisë, të paguara entiteteve jorezidente, pa një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë;

ç) të ardhurat nga interesat që u paguhen bankave dhe institucioneve të tjera financiare.

Neni 59

Norma e mbajtjes së tatimit në burim

Norma e mbajtjes së tatimit në burim mbi dividendët është 8%. Norma e tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat dhe pagesat sipas nenit 58 të këtij ligji është 15%.

KREU VI

TATIMI I TRASHËGIMISË, DHURATAVE DHE FITIMEVE NGA LOJËRAT E FATIT

Neni 60

Tatimi i trashëgimisë, dhuratave dhe fitimeve nga lojërat e fatit

1. Kreu VI i këtij ligji aplikohet ndaj personave fizikë dhe entiteteve që janë:

a) rezidentë në Republikën e Shqipërisë, të cilët marrin një dhuratë ose trashëgimi të aseteve të ndodhura në Shqipëri ose jashtë saj, ose marrin fitime nga lojërat e fatit të zhvilluara në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj; dhe

b) jorezidentë në Republikën e Shqipërisë, që marrin një dhuratë ose trashëgimi të aseteve të ndodhura në Shqipëri, ose marrin fitime nga lojërat e fatit të zhvilluara në Shqipëri.

2. Të ardhurat nga lojërat e fatit janë të ardhurat e fituara nga kategoritë e lojërave të fatit, sipas përcaktimit të tyre në legjislacionin në fuqi për lojërat e fatit.

3. Dhuratat në kuptim të këtij neni përfshijnë pasurinë e luajtshme ose të paluajtshme ose paratë e fituara pa ndonjë kompensim në këmbim.

4. Trashëgimi në zbatim të këtij neni përfshin pasurinë e luajtshme ose të paluajtshme ose paratë e fituara si rezultat i kalimit për shkak të vdekjes nga personi i vdekur tek trashëgimtarët e tyre, pasi janë zbritur detyrimet e trashëgueshme.

5. Fitimet nga lojërat e fatit tatohen veçmas dhe nuk mund të grupohen.

6. Pasuria nga dhuratat dhe trashëgimia vlerësohen me vlerë nominale ose vlerën e tregut, cila prej tyre është vlera më e madhe. Rregullat e vlerësimit për llogaritjen e fitimeve kapitale sipas këtij ligji zbatohen gjithashtu ndaj pasurisë nga dhuratat dhe trashëgimia.

7. Përjashtohen nga tatimi:

a) dhurimet dhe trashëgimia e përfituar nga/ose ndërmjet trashëgimtarëve ligjorë në radhë të parë dhe të dytë, sipas neneve 361 deri 363 të Kodit Civil, si dhe dhurimet dhe trashëgimia brenda lidhjes gjinore motër-vëlla;

b) dhurimet dhe trashëgimitë të marra përveç atyre të përcaktuara në shkronjën “a” deri në 5 000 000 lekë për tatimpagues për pasuritë e paluajtshme dhe deri në 1 000 000 lekë për pasuritë e luajtshme për tatimpagues;

c) kalimi i së drejtës së pronësisë trashëgimtarëve ligjorë sipas neneve 361 deri 363 të Kodit Civil, përkatësisht nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, kur prona rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar.

8. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim kërkesat në lidhje me verifikimin e burimeve të krijimit të pasurive të trashëguara apo të dhuruara.

9. Norma e tatimit për trashëgimitë, dhuratat dhe të ardhurat nga lojërat e fatit sipas këtij neni është 15%, pa zbritjen e ndonjë kostoje.

KREU VII

DISPOZITA TË MBLEDHJES SË TATIMIT

Kapitulli 1
Dispozita të përgjithshme

Neni 61
Deklarata tatimore vjetore

1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor.
2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.
3. Në rast se tatimpaguesi ka vdekur, deklarata plotësohet nga trashëgimtarët e tij ligjorë për të ardhurat e përgjithshme të krijuara deri në datën e vdekjes.
4. Në rast se tatimpaguesi ndryshon rezidencën tatimore, ai duhet të bëjë deklaratë tatimore për çdo të ardhur të krijuar deri në datën e ndryshimit të rezidencës.
5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.
6. Tatimi për t'u paguar nga tatimpaguesi paguhet në llogaritë e autorizuara nga thesari i buxhetit të shtetit.

Neni 62
Kërkesat për dokumentacion

1. Baza tatimore përcaktohet duke rregulluar shpenzimet dhe të ardhurat e deklaruara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj.
2. Dokumenti i përdorur si bazë për justifikimin e shpenzimeve për qëllime tatimore është fatura, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit për shitjet me dhe pa para në dorë, si dhe çdo dokument tjetër i përgatitur ose i nxjerrë në përputhje me udhëzimet e miratuara nga ministri përgjegjës për financat.

Neni 63
Parapagimet

1. Ky nen zbatohet për:
a) të vetëpunësuarit ose personat fizikë tregtarë, për të ardhurat e tyre nga biznesi; dhe
b) entitetet.
2. Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan në llogarinë e organeve tatimore këstet tremujore të tatimit mbi fitimin brenda datës 31 mars për muajt janar, shkurt dhe mars; brenda datës 30 qershor për muajt prill, maj dhe qershor; brenda datës 30 shtator për muajt korrik, gusht dhe shtator dhe brenda datës 31 dhjetor për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor. Këstet mund të paguhen edhe në baza mujore, jo më vonë se data 15 e çdo muaji, në shumat si më poshtë:
a) për çdonjërin nga muajt janar, shkurt dhe mars të periudhës vijuese tatimore, në shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën tatimore të para dy vjetëve të pjesëtuar me 12;
b) për çdonjërin nga 9 muajt e tjerë të periudhës vijuese tatimore, shumën e tatimit mbi fitimin për periudhën paraardhëse tatimore pjesëtuar me 12.

3. Rastet e parapagimeve të tatimit kur tatimpaguesi e fillon veprimtarinë gjatë periudhës tatimore të vitit të dytë paraardhës, gjatë periudhës paraardhëse tatimore apo në periudhën vijuese tatimore detajohen në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

4. Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, gjatë periudhës tatimore vërteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve sipas rregullave të parashikuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

5. Nëse organet tatimore vlerësojnë se bazuar në treguesit e 9-mujorit të parë, të ardhurat për periudhën vijuese tatimore do të tejkalojnë çdo muaj me më tepër se 10 për qind të ardhurat mesatare mujore të periudhës së kaluar, ato mund të rregullojnë në rritje parapagimet e tremujorit të fundit të vitit në përputhje me të ardhurat e vlerësuara prej tyre.

Neni 64

Deklarata plotësuese tatimore

1. Në rastin kur tatimpaguesi konstaton se tatimi i pagueshëm në deklaratën e tij të fundit të të ardhurave duhet të ishte më i lartë ose humbja tatimore më e ulët, ai është i detyruar të dorëzojë një deklaratë tatimore shtesë dhe të paguajë diferencën midis tatimit të deklaruar më parë të pagueshëm dhe tatimit suplementar të pagueshëm, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

2. Në rastin kur tatimpaguesi konstaton se tatimi i pagueshëm në deklaratën e tij të fundit të të ardhurave duhet të ishte më i ulët ose humbja tatimore më e lartë, ai është i detyruar të dorëzojë një deklaratë tatimore shtesë sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Kapitulli 2

Dispozitat e mbledhjes së tatimit mbi të ardhurat personale dhe personat jorezidentë specifikë

Neni 65

Agjenti tatimor i listëpagesës

1. Çdo punëdhënës, i cili ka detyrimin të paguajë të ardhura nga punësimi, është i detyruar të mbajë tatimin mbi këto të ardhura, të dorëzojë listëpagesën dhe të transferojë tatimin e mbajtur në listëpagesë në llogarinë e thesarit të buxhetit jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës për entitetet ~~dhe jo më vonë se data 20 e muajit që pason çdo 3-mujor për individët e vetëpunësuar apo individët tregtarë~~ dhe individët e vetëpunësuar apo individët tregtarë të regjistruar për TVSH-në, dhe jo më vonë se data 20 e muajit, që pason çdo 3-mujor për individët e vetëpunësuar apo individët tregtarë, që nuk janë të regjistruar për TVSH-në:

Agjenti tatimor i listëpagesës është i detyruar të mbajë tatimin sipas kësaj pike:

a) shkallën progresive të tatimit sipas nenit 24 të këtij ligji nëse tatimpaguesi i të ardhurave personale nënshkruan deklaratën mbi statusin personal me këtë punëdhënës, sipas nenit 66 të këtij ligji;

b) 15% të pagesës në rastet e tjera që nuk përfshihen në shkronjën "a" të kësaj pike dhe që nuk konsiderohen të ardhura nga marrëdhënie punësimi.

Agjenti tatimor i listëpagesës është i detyruar të marrë në konsideratë në baza mujore 1/12 e zbritjeve nga baza e tatimit, sipas shkronjave "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji, dhe zbritjet nga baza e tatimit sipas nenit 20 të këtij ligj kur llogarit në listëpagesë tatimin mbi të ardhurat për të punësuarin që ka nënshkruar deklaratën mbi statusin personal me këtë agjent tatimor të listëpagesës. Nëse punëmarrësi është në marrëdhënie punësimi edhe në punëdhënës të tjerë, këta punëdhënës të tjerë, në rolin e agjentit të listëpagesës, do të aplikojnë shkallën progresive të tatimit

sipas nenit 24 të këtij ligji dhe nuk do të aplikojnë zbritjet nga baza e tatimit sipas nenit 22, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij ligji.

2. Zbritjet dhe kompensimet sipas pikave 1, shkronja “ç”, dhe 2 të nenit 22 dhe sipas nenit 23 të këtij ligji, mund të kërkohen nga tatimpaguesit e tatimit mbi të ardhurat personale vetëm në deklaratën tatimore vjetore.

3. Çdo punëdhënës duhet të mbajë regjistrime të të ardhurave të paguara dhe tatimit të mbajtur dhe të dorëzojë listëpagesën në përputhje me përcaktimet e legjislacionit tatimor dhe legjislacionit mbi kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësorë, si dhe udhëzimeve të nxjerra nga ministri përgjegjës për financat në zbatim të këtyre ligjeve. Forma, përmbajtja, afatet dhe procedurat për dorëzimin e listëpagesës përcaktohen në aktet nënligjore të ministrit përgjegjës për financat, të nxjerrë në zbatim të legjislacionit tatimor, përfshirë këtë ligj, si dhe legjislacionit mbi kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

4. Agjentët tatimorë të listëpagesës janë përgjegjës për pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi me të njëjtën përgjegjësi sikur ai të ishte borxhi i tyre tatimor.

(Ndryshuar me Akt Normativ Nr. 7, datë 14.12.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 182, datë 16.12.2023)

Neni 66

Deklarata mbi statusin personal

1. Një agjent tatimor i listëpagesës kërkon që çdo punëmarrës të nënshkruajë një deklaratë për statusin personal para pagesës së parë të të ardhurave të tatueshme të punësimit.

2. Një punëmarrës nuk mund të nënshkruajë deklaratën për statusin personal me më shumë se një agjent tatimor të listëpagesës për të njëjtën periudhë kalendarike mujore.

3. Deklarata mbi statusin personal përfshin të gjitha informacionet e nevojshme për të pretenduar zbritje nga e ardhura e tatueshme sipas nenit 22, pika 1, të këtij ligji .

4. Në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat parashikohet forma e formularit të deklaratës mbi statusin personal që plotësohet nga punëmarrësi.

Neni 67

Deklarata vjetore e të ardhurave personale

1. Një individ është i detyruar të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore personale kur të ardhurat tatimore vjetore të tij/saj janë:

a) më shumë se 1 200 000 lekë në vit nga të gjitha burimet: ose;

b) kur është në marrëdhënie punësimi me më shumë se një punëdhënës, pavarësisht nga shuma e të ardhurave që merr nga punëdhënësit;

c) më shumë se 50 000 lekë e çdo të ardhure tjetër që nuk i nënshtrohen tatimit përfundimtar në burim, sipas kreut V të këtij ligji.

2. Çdo person fizik që kryen veprimtari ekonomike është i detyruar të dorëzojë deklaratën tatimore vjetore për të ardhurat nga biznesi.

3. Numri personal i identifikimit për individët apo numri unik i identifikimit të subjektit për tatimpaguesit e regjistruar përdoren si numra identifikimi tatimorë të tatimpaguesve rezidentë të të ardhurave personale për qëllime të deklaratës tatimore mbi të ardhurat personale. Tatimpaguesve jorezidentë u jepet një numër identifikimi tatimor sipas përcaktimit në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

Neni 68

Deklarimi dhe pagesa nga personat jorezidentë specifikë

1. Një personi jorezident, i përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 27 të këtij ligji, i kërkohet të përgatisë një deklaratë të tatimit mbi të ardhurat sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për financat. Deklarata duhet të dorëzohet sipas afatit të përcaktuar në nenin 61, pika 2, të këtij ligji.

2. Në kohën e paraqitjes së deklaratës sipas pikës 1 të këtij neni, personi jorezident duhet të paguajë shumën e tatimit të deklaruar. Neni 63 i këtij ligji nuk zbatohet për këto raste.

KREU VIII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 69
Dispozitë kalimtare

1. Lehtësitë dhe përjashtimet tatimore të parashikuara në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, vazhdojnë të zbatohen si më poshtë:

a) për personat, të cilët zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm" sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, shkalla e tatimit mbi të ardhurat 5% do të zbatohet deri më 31 dhjetor 2029;

b) për entitetet, që operojnë në struktura akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special" sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*", përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat korporative do të vazhdojë të zbatohet sipas përcaktimeve të shkronjës "g" të nenit 18 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar;

c) për entitetet, të cilat zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas ligjit nr. 38/2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor", shkalla e tatimit mbi të ardhurat në normën 5% do të zbatohet deri më 31 dhjetor 2029;

ç) për personat juridikë, të regjistruar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike për prodhimin apo zhvillimin e *software*-ve, tatimi mbi fitimin me normën 5% do të zbatohet deri më 31 dhjetor 2025;

d) për entitetet, të cilat ushtrojnë veprimtari ekonomike në industrinë automotive, shkalla e tatimit mbi të ardhurat 5% do të zbatohet deri më 31 dhjetor 2029;

dh) për:

i. individët tregtarë;

ii. të vetëpunësuarit, si dhe;

iii. entitetet:

me të ardhura bruto deri 14 milionë lekë në vit, norma e tatimit mbi të ardhurat 0% do të aplikohet deri më 31 dhjetor 2029. Norma e tatimit 0% nuk aplikohet për tatimpaguesit e përcaktuar në nënndarjet "ii" dhe "iii" të kësaj shkronje, të cilët furnizojnë shërbime profesionale. Lista analitike e shërbimeve profesionale përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi rregullues lidhur me këto shërbime profesionale.

e) Për të gjithë tatimpaguesit, të regjistruar para datës 31 dhjetor 2023, të cilët janë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin apo tatimit mbi fitimin, si edhe për ata që regjistrohen për herë të parë në vitin pasardhës, për efekt të periudhës tatimore 2024, do të përdoren formularët dhe përgjegjësitë tatimore, sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar;

ë) Parapagimet, sipas nenit 63, të këtij ligji, për kategoritë e personave, të cilët furnizojnë shërbime profesionale dhe janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat nga data 1 janar 2024, përjashtimisht për vitin 2024, llogariten bazuar në deklaratat e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimit mbi fitimin të viteve paraardhëse, duke zbatuar normat tatimore të parashikuara në këtë ligj;

f) Deklarata e tatimit të mbajtur në burim, sipas nenit 57, të këtij ligji, do të zbatohet duke filluar nga periudha tatimore janar 2025. Për vitin 2024 do të përdoret deklarata sipas modelit ekzistues.

2. Tabela e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi për periudhën nga 1 qershor ~~2023 deri më 31 dhjetor 2023~~ deri më 31 dhjetor 2024 është si më poshtë:

E ardhura nga paga në lekë/muaj		E ardhura e tatueshme në lekë/muaj		Norma tatimore në përqindje/mujore
Nga	Deri në	Nga	Deri në	
0	50 000	0	50 000	0%
50 001	60 000	0	35 000	0%
		35 001	60 000	13% të shumës mbi 35 000 lekë
60 001	Më tepër	0	30 000	0%
		30 001	200 000	13% e shumës mbi 30 000 lekë
		200 001	Më tepër	22 100 lekë + 23% të shumës mbi 200 000 lekë

3. Neni 54 i këtij ligji aplikohet për humbjet e krijuara nga viti 2024 e në vijim.

4. Përjashtimisht parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, tatimpaguesit, eksportues të mallrave në regjimin e përpunimit aktiv, të cilët në vitin 2022 kanë eksportuar jo më pak se 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, nuk paguajnë kështet që parapaguhen në muajt qershor, shtator dhe dhjetor të vitit 2023.

5. Deri në datën e fillimit të efekteve të këtij ligji, sipas përcaktimit të nenit 72 të tij, zbatohen parashikimet e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar me përjashtim të shkronjave "e", "ë" dhe "f", të këtij neni, zbatimi i të cilave do të bëhet sipas parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, deri në periudhën dhjetor 2024.

(Shtuar me Akt Normativ Nr. 2, datë 07.06.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 92, datë 23.06.2023)
(Shtuar me Akt Normativ Nr. 7, datë 14.12.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 182, datë 16.12.2023)

Neni 70

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda një periudhe 3-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim neneve 14, pika 3, 17, pika 6, 49 dhe 69 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që brenda një periudhe 3-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë udhëzimin e përgjithshëm për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe udhëzimin për transferimin e çmimit dhe marrëveshjet e çmimit në avancë.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës që brenda një periudhe 3-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojnë udhëzimin për tatimin mbi kalimin e së drejtës së pronësisë së paluajtshme.

Neni 71

Shfuqizime

1. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Pika 1 e nenit 9, si dhe kreu III i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 72
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2024, me përjashtim neneve 22, 23, 24, pika 1, që shtrijnë efektet nga data 1 janar 2025, të shkronjës "ç" të pikës 1 të nenit 69, që i fillon efektet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, dhe pikës 2 të nenit 69, që i fillon efektet nga data 1 qershor 2023.
(Shtuar me Akt Normativ Nr. 7, datë 14.12.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 182, datë 16.12.2023)

Miratuar më datë 30.3.2023.

Shpallur me dekretin nr.59, datë 24.4.2023 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 70, datë 02.05.2023

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Ndryshuar me:
- Akt Normativ Nr. 2, datë 07.06.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 92, datë 23.06.2023
- Akt Normativ Nr. 7, datë 14.12.2023, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 182, datë 16.12.2023